

BIBLIOTEKA
E
85H-32
L 96
SHETIT
GJIROKASTËR

ALEKS
LUARASI

TREGIME

SEANCE

ME DYER
TE HAPURA

891.783-32

S

LP2

ALEKS LUARASI

SEANCË ME DYER
TË HAPURA

(Tregime)

~~53758~~

LIBRARI E SHKOLLËS
1970

1970

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

GORICARËT

1.

Vjeshtë e vitit 1932.

Tre burra shtynë derën prej hekuri të gjykatës së diktimit në Tiranë dhe u gjendën në një oborr gjithë lule dhe pemë dekorative. Vështrimi i tyre ndoqi rrugën e shtruar me pllaka të lëmuara, që bashkonte derën e jashtme me shkallët e gurta të ndërtesës dhe mbeti mbi trupin e një statue prej mermeri të bardhë, që ngrihej gjithë dinjtet midis gjelbërimit. Drejtësia, e përfytyruar si një grua me sy të lidhur me shami, rrinte ditë e natë para gjykatës së diktimit duke mbajtur në njërën dorë ballancën dhe në tjetrën një shpatë.

Një pamje me të vërtetë klasike!

Nën shtyllat e gurta në stil dorik, që mbanin ndërtesën si në pëllëmbë të dorës, çdo njeri ndjente pushtetin e padiskutueshëm të drejtësisë.

Tre katundarët tanë hynë gjithë ndrojtje në këtë ambient kaqë të bukur e njëkohësisht kaqë të huaj për ta. U printe një plak 60-70-vjeçar, me flokë të thinjur e fytyrë eshtake. Pasi kaloi mes për mes oborrit, ai u mbështet në trungun e një palme dhe po thithte në heshtje tymin e duhanit nga llulla prej shqopeje që e kishte punuar vetë. Dy të tjerët, që ishin më të rinj, rrinin për-

ballë tij dhe vështronin me kureshtje rrugën përtej kangjellave prej hekuri, ku kalonin gjithë zhurmë hamejtë dhe karrocet.

Plaku nuk e tërhiqnin bukuritë e qytetit. Ai vështronte tokën që kishte nën këmbë dhe diç bluante me vete.

Toka... — tha ai — Sa gjak është derdhur për një pëllëmbë tokë! — Dhe para syve të plakut dilte beu, agai, qehajaj, gjykatësi, dilnin ata që i xhvatnin fukarasë sa më tepër tokë. — Po — tha plakuri. — Rrëmbe andej, rrëmbe këtëj dhe fshati u zvogëlua e u mblodh në një pëllëmbë vend. Në fillim u kishin marrë pyllin dhe pastaj kullotat. Dhe para syve të plakut u ndër hapsira e bukur e fshatit, — Tani duan dhe tokën dhe shtëpinë, duan të na përzënë.

«More, a ka qeveri këtu, a ka drejtësi në botë?» — tha me vete plakuri duke vështruar truporen e drejtësisë.

«Po, ka!» — iu bë sikur i foli statuja. «Pse, kot e mbaj unë në duar këtë ballancë dhe këtë shpatë?...».

Plakuri u përmend dhe i kaloi një buzëqeshje e lehtë dhe e hidhur ndër buzë, sepse iu kujtua gjyqi i Korçës...

Kishte qenë gjyq i madh ai dhe kishte zgjatur shumë.

Vite me radhë Maliq beu dhe larot e tij, qehajallarët, vinin në fshat dhe kërcënonin: «O jepni të tretën, ose ju nxorëm nga fshati me gjithë lecka». Me ta u bashkuan edhe prefektura, edhe xhandërmaria, edhe gjykata. S'thonë kot: sorra

sorrës s'ja nxjerr sytë. Bëj hesap, edhe ligjet u ndryshuan sipas oreksit të bejlerëve.

Mirëpo goricarët nuk tundeshin.

Ata i kishin dhënë besën njëri tjetrit se do të qëndronin gjer në fund. «Toka është jona — kishin thënë goricarët, — ne e kemi punuar denbabaden, prandaj Maliq beut nuk i japim as kaqë!»

Kur e pa se me goricarët nuk i dillej, Maliq beu i hodhi në gjyq. Ishin shumë ata: një qind e ca frymë si të paditur. Jashtë i priste i tërë fshati, burra, gra e kalamaj. Dy-tre avokatët e beut dukeshin si miza para gjithë atij fshati që nuk i nxinte salla. Dhe ishin të zemëruar. Burrat tundnin grushtet me urrejtje, gratë bërtisnin me të madhe, por nuk i dëgjoji njeri. Beu fitoi njërin gjyq pas tjetrit. U mori pyllin dhe kullotat në fillim, kurse, në gjyqin e fundit, fitoi edhe tokat me shtëpitë e banimit: me një fjalë gjithë fshatin. Dikur i ati i Maliq beut i kish vënë një sërë tak-sash fshatit. Tani i biri kërkonte t'i merrte tokën dhe shtëpinë.

Goricarët u zemëruan keq. S'i thonë shaka! Kjo ishte luftë për tokën, luftë për bukën, luftë për jetën. Kërkuan që ta ndiqnin çështjen më lart. Mirëpo gjyqi do para. Shitën bagëti dhe plaçka; gratë nxorën nga sënduku stolitë e nusërisë; i shitën të gjitha, mblodhën para dhe dërguan njerëz gjer në Stamboll për të parë tapitë e tokave.

Por atje ata i përzunë, nuk u dhanë gjë. Fshatarët vetëm një gjë dinin mirë, që Maliq beu kësaj ane nuk kishte zotërime. Dhe ata s'kishin dokument, por dhe beu s'kish tapi.

Kështu, pra, bënë kaqë ditë rrugë dhe ardhën

në Tiranë për të kërkuar drejtësi. Vinin me shpresë se këtu ishte qeveri e madhe dhe ndoshta do ta shihte çështjen më mirë, vinin me shpresë se në Tiranë Maliq beut ndoshta nuk do t'i shkonte fjala si në Korçë, ku kishte fuqi dhe miq të shumtë.

— Ç'thua, xha Nini, sikur të kishim marrë një avokat, a nuk do të qe më mirë? -- pyeti njëri prej tyre.

Plaku nuk foli.

— Kot, a derëzi, sa të prishnim paratë -- u pëgjegj në vend të tij bashkëbisedonjësi tjetër, një djalë i ri, jo më tepër se njëzet e pesë vjet, me faqe të kuqe e trupin si llastar. — Dihet se ne kemi të drejtë, po kush ta jep se! .. Puna jonë u duk që në Korçë, Vasil. A nuk e pe gjykatësin se si i mbante anën Maliq beut? Ti kujton se këta të Tiranës do të jenë më të mirë?..

— Nejse! — kundërshtoi Vasili. — Ne të bëjmë ç'kemi në dorë, pa të hollat do t'i mblidhte gjithë fshati pesë e pesë.

Boçoja nuk foli, por u duk se nuk ishte dakord me mendimin e shokut të vet. U tërhoq mënjandë dhe po vështronte oborrin me kureshtje.

Ishte me të vërtetë i bukur.

Mbi lulet vjeshtake shumëgjyrëshe, që harliseshin në të dy anët e oborrit, kishte plot pika uji. Ato sapo ishin vaditur. «Sa shumë tokë dhe vetëm për lule!» mendoi Boçoja, tek shikonte ato lule të bukura që kishin çelur gonxhe gjithfarësh, të kuqe, të verdha, manushaqe. Mbi shkallët prej mermeri të bardhë të gjykatës së diktimit, mbi

pllakat e bukura e të lëmuara, me gjithë ato kombinime të çuditshme, që të merrnin mendjen kishin rënë gjethe të zverdhura, të thata e të fishkura. Kopshtari, që shërbente aty, u hodhi një vështrim indiferent atyre tre katundarëve, që prisnin sa të hapej gjyqi dhe shkoi më tutje me një fshesë në dorë.

Matanë kangjellave u ndal një veturë. Një burrë rreth të pesëdhjetave, veshur me kastum të errët dhe këmbë të bardhë, hyri hijerëndë në oborr. Kaloi afër goricarëve pa i vështruar me sy dhe ngjiti me ngadalë shkallët e gjykatës së dikimit. Ai e dinte fort mirë ç'ishin ata të tre... Pas disa minutash do të ndeshej me ta si përfaqësonjës i Maliq beut, por... (Avokat Konicës i qeshej)! ç'kundërshtarë mund të qenë ata tre copë katundarë që, sigurisht, s'dinin të lidhnin dy fjalë para atij që kishte mbaruar fakultetin e drejtësisë dhe numëronte më tepër se pesëmbëdhjetë vjet praktikë në drejtësi? Pastaj, në këtë çështje, ai e kish të fituar davanë me siguri sikur hiç të mos e hapte gojën: gjyqi kishte rëndësi politike. Luftonin përballë njëri-tjetrit beu dhe fshatarët e tij për çiflikun e Goricës. Në anën e beut kishte ndërhyrë edhe qeveria. Vetë Musa Juka i kishte thënë personalisht: «Dëgjo, avokat Konica! Jepu një mësim të mirë atyre katundarëve rebelë; sa për të tjerat do të kujdesem vetë...»

Kështu arsyetonte avokat Konica tek hynte në korridor, ndërsa goricarët e vështronin nga prapa.

Fill mbas tij, te shkallët, u duk ftuesi i gjykatës, një dibran i gjatë si vastarkë, që bërtiti me sa zë pati, megjithëse ata të tre ishin fare afër.

— Maliq bej Frashëri kundër goricarëve!

Ja, erdhi çasti kur do të vendosej fati i tyre dhe i gjithë fshatit, që priste me ankth përfundimin e këtij gjyqi me rëndësi. Xha Nini nuk e humbi to-ruan. Duke ngjitur shkallët, ai diç bisedonte me Boçon.

Në sallën e gjykatës së diktimit tre goricarët e ndjenin veten si të huaj. Perdet e rënda prej damasku, parketi i lustruar me kujdes dhe gjithë ai ambient luksoz, që i rrethonte, u merrte frymën. Përballë tyre avokat Konica shfletonte me nge dekretin e ri «Mbi padjnat posedimore».

Në fillim foli një nga anëtarët e gjykatës. Me një zë të ngjirur e të pafuqishëm ai shpjegoi se gjykata e paqit në Korçë kishte vendosur detyrimin e katundarëve të Goricës të dorëzonin tokat e tyre në favor të Maliq bej Frashërit dhe të largoheshin përfundimisht nga fshati.

Pas tij, kryetari i kolegjit civil, një burrë shtatlartë e flokëthinjur, iu drejtua goricarëve:

— Po ju ç'keni për të thënë, përse ankoheni?


Në emër të goricarëve foli xha Nini. Kur u ngrit, vështroi një herë Vasilin që kishte nga e djathta pastaj Boçon nga e majta dhe iu duk sikur pa të gjithë bashkëfshatarët e tij, gjashtëqind e ca frymë, burrat me vetulla të vrejtura, gratë me fëmijë në krahë, të rinj e pleq, të gjithë ata që e kishin porositur të drejtat e tyre para gjykatës së lartë. Kujtimi i tyre bëri që të fliste më mirë, ashtu sikurse nuk kishte folur ndonjëherë:

— Zoti kryetar, zotërinj gjyqtarë! — tha ai.

Kam nderin të flas në emër të 112 familjeve të katundit Goricë, të prefekturës së Korçës, të cilët i ka hedhur në gjyq Maliq bej Frashëri. Ç'është e vërteta, do të na takonte ne e drejta për ta hedhur në gjyq këtë bej për shumë të këqia që ka punuar në kurrizin tonë, por nganjëherë punët ngjasin së prapi.

Shkurtimisht po ju tregoj, zotërinj gjyqtarë, se shtëpitë, tokat, vreshtat dhe pylli i Goricës na takojnë neve, goricarëve, se Maliq bej Frashëri vërtet është bej, dhe qoftë me shëndet, por Goricën nuk e ka pasur kurrë ndonjëherë çiflik të tij. Ai thotë se fshati ynë i është dhuruar një gjysh-stërgjyshi të tij prej sulltanit të Turqisë dhe kërkon që ta njohim për zot e t'i japim të tretën. Ky avaz nuk është i ri. E kemi dëgjuar shumë vjet përpara, qysh në kohë të Turqisë, por ne asnjëherë nuk e kemi njohur për bej. Në atë kohë na ka detyruar me forcë që t'i jepnim një pjesë të bereqetit; dërgonte xhandarë turq dhe «trima» të tij, të cilët na e rrëmbenin nga lëmi apo nga hambari, kudo që ta gjenin. Ai ka punuar në kurrizin tonë shumë të këqia dhe s'na ka mbrojtur njeri, as prefektuara, as xhandërmaria dhe as qeveria. Përkundrazi e kanë ndihmuar të na rrëmbente me forcë pyllin dhe kullotat; tashti kërkon të na marrë me gjyq edhe arat e shtëpitë që i kemi ngritur me duart tona. Për çudi gjykata e paqit në Korçë i dha të drejtë dhe na detyroi ne njëqind e ca familje, me gjashtëqind e ca frymë gjithsejt të ikim nga fshati dhe të lemë në dorë të Maliq beut gjithshka që kemi vënë me djersën e ballit.

Zotërinj gjyqtarë! Maliq beu nuk i ka tapitë e



tokave tona. Ne kemi dërguar njerëz gjer në Stamboll...

— Dëgjo, o plak, — e ndërpreu kryetari i kolegjit civil me një zë të vrazhdë, — neve nuk na duhet se ç'keni bërë ju në Stamboll... Përqëndrohu rreth thelbit të çështjes.

— Na falni, zoti kryetar, — kërkoi ndjesë xha Nini me shumë mirësjellje, — se ne jemi fshatarë dhe nuk dimë të flasim si duhet. Atëhere, me lejen e zotërisë suaj, po vazhdoj. Historia e grindjes sonë me Maliq bej Frashërin është kështu.

— Të thashë edhe një herë — e ndërpreu sërishtmi kryetari, — se neve nuk na duhen historira...

— Po çfarë ju duhet juve, zoti kryetar?

— A keni ju ndonjë shkresë që të rovoni se i mbani tokat në mirëbesim ashtu siç e kërkon ligji?... Ja, këtë kërkojmë ne.

Xha Nini nuk po kuptonte gjë për sa po fliste kryetari. Megjithatë ajo puna e shkresës iu kujtua: ja kishte thënë avokati i tyre qysh në gjyqin e Korçës dhe ai u përgjegj i revoltuar.

— Për besë nuk po e marr hiç vesh se ç'kërkoni nga ne katundarët e shkretë. Shkresë! Po ne i kemi tokat tona denbabaden e nuk i kemi blerë. Nga do ta merrnim shkresën?!...

— Mirë, mirë, vazhdo — tha kryetari i kolegjit me një ton sikur të thoshte që «për mua kaqë mjafton, ti po deshe folë, po deshe rri në vend».

— Gjykata e Korçës — vazhdoi xha Nini, megjithëse e dinte që të pesë gjyqtarët nuk e dëgjonin fare, — besoi thënjet e dëshmitarëve të rremë që paraqitën avokatët e Maliq bej Frashërit. Të gjithë gënjyen pa pikë turpi. Ata thanë se Gorica paska qenë gjithnjë çiflik i Maliq beut, se ne kemi qenë bujqërit e tij dhe gjoja i kemi paguar çdo vit të tretën. Këto nuk janë të vërteta. Gënjeshtër e tyre doli që në gjyq. Kështu, kur jallanshahitët e Maliq beut thanë se na njihnin ne kokë për kokë, mbasi gjoja kishin qenë në fshat kur i kishin paguar beut të tretën, ne i pyetëm se si e kishim emrin, kurse ata nuk dinin ç'të thoshin. Kjo është shënuar edhe në procesverbal.

— Mjaft, mjaft — e ndërpreu kryetari.

— Ne kemi kërkuar prej gjykatës së Korçës që të na lejonte të paraqisnim dëshmitarët tanë, por gjykatësi na ndaloi, duke thënë se duhet t'i kishim me vete.

Tek fliste xha Nini, pesë burra me kostume të errëta qëndronin të heshtur matanë tribunës. Në fytyrën e tyre nuk dukej as emocioni më i vogël, megjithëse ishte fjala për jetën e një fshati të tërë. Ata pothuajse nuk dëgjonin fare. Kryetari shfletonte dosjen sa për t'u gjendur në punë, një tjetër kruante thonjtë me vëmendje të përqëndruar në punën e tij, i treti ishte si përgjumësh dhe kështu me radhë. Të pestë prisnin me padurim sa të mbaronte xha Nini.

— A është e drejtë, zotërinj gjyqtarë, — përfundoi xha Nini, — të hidhet në mes të katër rrugeve një fshat i tërë, me burra, gra e kalamaj, sepse nuk i nënshtrohet Maliq bej Frashërit?..

Ne kemi jetuar denbabaden në Goricë; në ato toka nxjerrim bukën e fëmijëve, atje kemi varret e të parëve dhe, po të jetë nevoja, do të hapim edhe varret tona, por nga fshati nuk luajmë!

Xha Nini u ul dhe pas tij e mori fjalën avokat Konica.

— Kjo çështje ka rëndësi të madhe për familjen tonë — tha ai në emër të Maliq bej Frashërit, — e cila, brez pas brezi, prej 200 e ca vjetësh, ka qenë posedore dhe zotëruese e këtij çifliku me famë. Bujqërit e këtij çifliku kanë punuar në tokat tona duke na paguar rregullisht të tretën. Në vitin 1912, që kur se midis 14 katundeve u okupua edhe çifliku ynë prej ushtrisë greke, bujqërit, domethënë të paditurit, të shtyrë nga elementë të jashtëm turbullues dhe tue përfitue nga muhaxhirllëku i familjes sonë, (e cila aso kohe la mall e gjë dhe iku nga Korça), tue përfitue nga situata e keqe e krijuar prej luftës ballkanike, u deklaruan revolucionarë kundrejt neve të zotërve të çiflikut me aq

rreptësi sa nuk guxonim të afroheshim në çiflik. Në atë kohë na dogjnë hanë, edhe fabrikën e miellit, edhe kullën, kurse çobanë, të cilin e kishin dërguar për të shikuar gjëndjen e çiflikut, e konsideruan si spiunin tonë dhe e dogjën në furrë për të tmerruar të tjerët që mos të afrohej njeri në çiflik. . .

Në sallë s'pipëtinte njeri. Gjyqtarët dëgjonin me vëmendje avokat Konicën dhe herë pas here vështronin goricarët.

Zoti Mirdita, një gjyqtar i vjetër, që rrinte në krahun e djathtë të kryetarit, i pëshpëriti atij në vesh:

— Bie erë bolshevizëm kjo puna e goricarëve, zoti kryetar. . .

Ndërkaq avokat Konica vazhdonte fjalimin i sigurt se kishte bërë me vete auditorin:

— Të paditurit pretendojnë se tokat e Goricës janë në posedim të tyre të ligjshëm. Ne u bëjmë një pyetje: A kanë ata ndonjë shkresë, e cila të ketë kuptimin e një titulli zotnimi për të provuar qëllimin (animusin) se e kanë mbajtur në mirëbesim, ashtu sikurse e kërkon neni 10 i ligjës «Mbi gjykimin e shpejtë të padinave posedimore»? . .

Ai kujtoi se nuk do të përgjigjej njeri, prandaj u bë gati të vazhdonte më tej, por ja ku u ngrit Boçoja dhe e ndërpreu në mes:

— Po beu i ka tapitë e çiflikut, zoti avokat?

Kryetari i gjykatës e quajti këtë ndërhyrje si shkelje të rregullit dhe i ra ziles. Ndërkaq avokat Konica përfundoi pa e humbur gjakftohtësinë:

— Ne kërkojmë të na lirohen gjithë trojet e katundit Goricë. Bujqërit kryengritës le të shkojnë në punën e tyre.

Të pesë anëtarët e gjykatës së diktimit kishin për të zgjidhur një problem me rëndësi. Maliq bej Frashëri nuk i kishte tapitë e çiflikut dhe, me sa dukej, s'kishte pasur as posedimin e tij, të paktën njëzet vjetët e fundit, gjë që e pranonte edhe vetë. Flitej se Gorica i ishte dhuruar një stërgjyshi të tij si shpërblim për shtypjen e kryengritjes së maqedonasve, por s'ishte asgjë e dokumentuar. Të drejtat e tij mbi çiflikun e Goricës s'kishin asnjë bazë nga pikëpamja juridike, mirëpo si t'ja bënin? Maliq beu ishte bej...

— Pra ç'mendim keni ju, zotërinj gjyqtarë? — i pyeti kryetari kolegët e tij kur u tërhoqën në dhomën e bisedimit.

U ulën në kolltukë dhe ndezën nga një cigare, duke biseduar lirisht.

— Atij plakut nuk ja hante qeni shkopin — tha duke qeshur lehtë zoti Niko, një gjyqtar më i ri se të tjerët, që kishte mbaruar studimet në Francë.

— Pisk do ta ketë pasur punën me ta Maliq bej Frashëri, — shtoi një tjetër.

— Me goricarët? — ndërhyri zoti Estref, që rridhte edhe vetë nga derë beu. — Mos e pyet! Ata janë kokëderra. T'i shtrosh në dru gjithë ditën, ja, kështu e duan ata...

— Sidoqoftë, kanë një çikë të drejtë... — tha zoti Niko.

— Kanë të drejtë thoni ju, zoti Niko? — ndërhyri energjikisht Estref beu. — Akoma ju me ato idetë e ndritura të revolucionit francez: liri, barazi, vëllazërim! Ç'vëllazërim! Me goricarët! Vëllazërohu

po deshe... Dru, ore, dru, kërbaç, ja, kështu e duan ata. Por ke hakë ti, je rehat; se të kishe nja dy-tre çifliqe si Maliq beu, do të të vinte festja vërdallë dhe do të flisje ndryshe. Këtu vjen erë-bolshevizëm, zoti Niko. Rusia u ka prishur mendjen fshatarëve tanë. Duan tokat tona tashti, nesër kush e di ç'do të kërkojnë.

— Estref bej, — Mos u nxehni — u tremb zoti Niko dhe filloi të tërhiqej. — Të kuptohemi, unë s'them që t'u japim të drejtë goricarëve dhe të lëmë Maliq benë pa çiflik, por ja, flas thjesht nga pikë-pamja juridike: Maliq beu nuk i ka tapitë e çiflikut.

— Vërtet, po ç'rëndësi ka kjo? Ne nuk kemi padinë e themelit, por padinë posedimore — vuri në dukje Estref beu duke buzëqeshur me dhelpëri.

— Mirë, atëhere le ta shohim problemin nga ana posedimore: e ka pasur ndonjëherë Maliq beu këtë çiflik në zotërim të tij?

— Posi jo? E thonë dëshmitarët.

— Po për parashkrimin¹⁾, ç'do të thoshit ju, Estref bej? — vazhdoi Nikoja me argumente juridike.

— Këtu jemi në rregull — u përgjegj Estref beu me kryelartësi; — janë zënë të gjitha shtigjet. Ligja e re «Mbi gjykimin e shpejtë të padinave posedimore» që doli kohët e fundit, cakton një afat njëvjeçar për ngritjen e padisë. Kjo fillon nga dita e daljes së saj. Maliq beu e ka ngritur padinë brenda këtij afati.

1) Parashkrim quhet në drejtësi shuarja e së drejtës së padisë me kalimin e një afati të caktuar në ligj.

— Dakord! — murmuriti Nikoja dhe u tërhoq në dritare.

Kryetari dhe gjyqtarët e tjerë dëgjonin me vëmendje. Ata e dinin se mendimi i zotit Niko kishte baza nga pikëpamja thjesht juridike, por nga pikëpamja politike ndryshonte puna... Fundi i fjalës nuk mund t'i jepej e drejta «opingës» dhe të lihej një bej pa çiflik!

— Mendimi im është ky, zoti kryetar, — mori fjalën zoti Mirdita një burrë tullac, fjalëpakë dhe tepër i matur. — Nga ana e formës padia është ngritur brenda afati njëvjeçar të parashkrimit që cakton ligja e re «Mbi gjykimin e shpejtë të padinave posedimore». Në themel, vendimi i gjykatës së paqit në Korçë është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi...

Pa mbaruar fjalën zoti Mirdita, ra zilja e telefonit. Flisnin nga oborri i Lartmadhërisë. Kryetari vuri receptorin në vesh dhe po dëgjonte me një nderim të veçantë.

— E shqyrtoat çështjen e Maliq bej Frashërit, zoti kryetar?

— Jo akoma, bej, për atë jemi mbledhur...

— E keni të qartë rëndësinë politike të vendimit që do të merrni, zoti kryetar?

— Si urdhëron, e kemi, bej, — u përgjegj ai shpejt e shpejt.

— ... dhe pasojat? — insistoi tjetri duke i dhënë kësaj fjale dy kuptime.

— Si urdhëron, edhe pasojat!..

— Shumë mirë, zoti kryetar, — u përgjegj tjetri i kënaqur, por kolegët tuaj si mendojnë?

— Si të them, bej, — tha kryetari duke vështruar nga kolegët e tij, — ne akoma nuk kemi

vendosur formalisht, por dakord jem të gjithë, bej...

Tek përgjigjej kryetari katër anëtarët e tjerë të gjykatës së lartë buzëqeshnin me kënaqësi dhe njëkohësisht tepër të emocionuar që një personalitet aqë i lartë tregonte vëmendje për mendimin e tyre.

Kur mbaroi bisedën kryetari i kolegjit civil të gjykatës së diktimit, vuri me kujdes dorezën e telefonit në vendin e vet dhe lëshoi një psherëtimë çlodhëse. Në ballë dhe në duar i kishin dalë bulëza djerse nga sikleti.

S'kaloi shumë dhe në korridor u dëgjuan hapat e një ushtaraku. Kryesekretari i gjykatës njoftoi se kishte ardhur një i dërguar i oborrit mbretëror dhe kërkonte zotin kryetar. Kur u hap dera, para anëtarëve të gjykatës së diktimit u shfaq figura e rreptë e një ushtaraku me mustaqe. Uniforma e stolisur pa kursim ja shtrëngonte trupin e dhjamur, por kapiteni i oborrit mbretëror e duronte trimërisht këtë vështirësi, mjaft që të dukej njeri i rëndësishëm me ato spaleta të arta, që i vareshin mbi supe dhe me gjithë ato nishane që i kishte varur Lartmadhëria nga viti 1924 e tutje.

— Tungjatjeta zotërinj, — tha ai pa u ulur në kolltukun që i treguan. — Vij nga oborri mbretëror për t'i prurë zotit kryetar dhe zotërinjve të tjerë të gjykatës së diktimit këto ftesa për të marrë pjesë në pritjen që organizon të dielën Lartmadhnia me rastin e...

Ata të pestë vështruan njëri-tjetrin të kënaqur. S'dinin se si ta prisnin më mirë kapitenin e oborrit mbretëror; e ftuan sërishmi të ulej në

1970

~~53758~~

kolltuk, i ofruan një cigare, por ai nuk pranoi se s'kishte kohë.

Pasi i përshëndeti me një «Puna mbarë, zotërinj!», kapiteni i oborrit mbretëror bëri një prapaktheu sipas rregullores, çeli derën dhe doli kryelartë.

Kryetari propozoi që të vendosnin përfundimisht.

— Ç'mendim keni ju, zoti Qemal? — ju drejtua ai anëtarit të pestë të kolegjit civil, njeri indiforent e flegmatik.

— Dakord — murmuriti ai.

— Zoti Mirdita?

— Dakord.

— Estref beu?

— Dakord.

— Po ju, zoti Niko?

— Dakord.

Kur kryetari shqiptoi vendimin, tre goricarët mbetën në vend si tre lisa. Ata vështronin fytyrat e verdha e pa jetë të gjyqtarëve, kostumet e tyre të errëta dhe u dukej sikur të pestë, si një trup i vetëm, kishin dalë nga errësira së bashku me vendimin e tyre.

— Jo! — tha xha Nini, ne nuk luajmë nga fshati!

— Ky vendim është i formës së prerë — u përgjegj shkurt kryetari.

— Le të jetë, — ja ktheu xha Nini gjithë inat. — Ne nuk na shkulni që andej.

Kryetari nuk u përgjegj, nuk foli as edhe ndonjë nga anëtarët e tjerë të gjykatës së diktimit. Ata ishin mësuar me këto protesta të fshatarëve, që humbisnin gjyqin, prandaj, për të mos

provokuar ndonjë të papritur, u larguan njëri pas tjetrit nga një derë, që ishte prapa tribunës.

Në sallë nuk mbeti njeri. Avokat Konica ishte larguar me kohë për t'i dhënë lajmin e gëzuar Maliq bej Frashërit, që priste në «Kristal».

Ata të tre dolën në verandë. Një fllad i lehtë, që vinte përmes gjelbërimit, u freskoi fytyrën dhe u kujtoi se duhej të ktheheshin në fshat.

— Ecni, djema! — urdhëroi xha Nini. — Do të luftojmë!...

Afër tyre, truporja e drejtësisë, e bardhë si bora, ngrihej gjithë dinjitet midis gjelbërimit, duke mbajtur në njerën dorë ballancën dhe në tjetrën një shpatë.

ZBRITJA

I

Lart mbi majat e maleve, u duk një aeroplan reaktiv, që, pasi bëri disa rathë në atë qiell të kaltër vere, çau përpara si shigjetë ergjëndi.

Aviatori Bujar Mersini po kthehej në aerodrom. Nga ato lartësi prej mijëra metrash ai kundronte tokën me kënaqësi. Aty poshtë shtrihej një pejsazh i bukur malor: pyje të dendur me gjelbërim të përhershëm, kreshta malesh të thepisura. Nën këmbët e tyre gjarpëronte një lumë si pasqyrë që herë dukej dhe herë zhdukej nën gjethet e pemëve. Pranë pyjeve shtriheshin fshatra të vegjël e me pak shtëpi, të cilat herë bashkoheshin dhe herë rrinin larg njëri-tjetrit. Çatitë e tyre dukeshin puq me tokën. Lart mbi to disa fjolla resh të bardha fluturonin me përtaci drejt perëndimit.

Detyrën e kishte kryer dhe duhej të kthehej në aerodrom. Ai vështroi tri llambat me të cilat do të kontrollonte hapjen e rrotave. Porsa të ulej dorëza, ato duhej të jepnin dritë të kuqe, por... dorëza mezi lëvizti nga vendi dhe u ndal. Nga llambat vetëm njëra u ndez me dritë të kuqe. Dy të tjerat qëndronin si më parë, të fikura. Pra, ishte hapur vetëm rrota e hundës, kurse dy të

tjerat, të krahëve, me siguri ishin bloukar. Në fillim ai dyshoi se mos qenë djegur llambat dhe, për t'i kontrolluar, shkeli sustën e tyre. U ndezën menjëherë. Pas kësaj u mundua të mbyllte rrotën e hundës, por më kot. Doreza nuk lëvizte nga vendi.

Pra, gjithshka ishte e qartë: ai nuk mund të hapte dy rrotat e krahëve e ndërkaq as që mund të mbyllte rrotën e hundës. Në këtë gjendje ulja ishte e pamundur. Sikur të mos hapej asnjë rrotë, ai do ta kishte më të thjeshtë. Në raste të tilla, aviatori e drejton aeroplanin gati paralel me sipërfaqen e tokës dhe e ndal diku në mes të aerodromit. Kjo ka ndodhur, por, të ulesh duke pasur të hapur vetëm rrotën e hundës, është e vështirë. Aeroplani reaktiv në raste të tilla përmbysset dhe piloti rrezikohet.

— Këtu treqind e treshi — njoftoi ai tokën me radio. — Rrotat e krahëve nuk më hapen. Llambat e kuqe nuk u ndezën të gjitha. Doreza e rrotave ka lëvizur pak dhe është bloukar.

— Mbaj gjakftohtësinë! — u përgjegj zëri i njohur i udhëheqësit të fluturimit. — Përpiqu edhe një herë!

U mbështet në sedile dhe vështroi atë dorezë të pabindur, që ishte bloukar. Si e kishte hallin që nuk lëvizte nga vendi? Sa mirë do të qe sikur të hapeshin rrotat!.

«Ja, — mendoi me vete, — tashi do ta ul dorezën dhe dritat e kuqe do të çelen!..»

Zgjati dorën, e kapi fort dorezën dhe e shtyti, një herë poshtë e përsëri lart, për ajo, si gjithmonë, qëndronte në vend, kryeneçe.

— E në je ti një herë kokëfortë, unë jam njëqind herë — tha me inat.

Pastaj e tundi disa herë në të dy drejtimet herë me forcë dhe herë me të butë, sikur donte ta merrte me të mirë për t'i shpëtuar asaj pengese të padukshme që e kishte bllokuar. Megjithatë, ajo nuk lëvizi nga vendi si edhe më parë.

Kësaj here e ndjeu thellë në veten e tij rrezikun që i kërcënohej.

«Po sikur të mos hapen rrotat?» — mendoi ai i shqetësuar dhe e ngriti avionin lart, shumë lart.

Vështrimi i tij rrëshqiti nga perëndimi.

Diku në breg të detit, në plazh, ishte e shoqja dhe e bija. Ato mbase kishin hyrë në det, kërcenin mbi valët kaltëroshe, sperkasnin njëra-tjetrën me cirka uji dhe qeshnin në atë çast aq të vështirë për të. Para syve, si në ekran, i kaloi gjithë jeta e tij: fëmijërija, dëshira për t'u bërë aviator, martesë me Lili... pastaj iu kujtua vajza dhe përsëri Lili.

Ndërkaq aeroplani ishte ngritur shumë lart. Aty poshtë shtrihej atdheu, i bukur, i fortë si një shkëmb, i mbuluar me një vello resh të bardha...

Dhe atij iu kujtua fluturimi i parë...

Ishte një ditë e bukur vere si kjo e sotmja. Të gjithë së bashku kishin dalë në pistën e aerodromit për të bërë fluturimin e parë. Ashtu të gëzuar dhe gjithë emocion vështronin herë dieclin flakëronjës, që shndriste mbi kokët e tyre dhe herë fushën e gjelbër të aerodromit me pistën e betonuar në mes. Kishin studjuar teori me muaj të tërë, ishin lodhur për të mësuar të fsheh-

tat e aeroplanëve reaktivë, që rrinin në mes të pistës të bukur, të lehtë si zogj, të përsosur si një mrekulli e teknikës; kishin ëndërruar gjithë jetën për këtë ditë...

Qysh atëhere ishte dashuruar me aeroplanin e tij. Të dy ishin bërë shokë të ngushtë, që gjithmonë e kuptonin mirë njëri-tjetrin.

Ndërsa aeroplani reaktiv fluturonte atje në qiell pa mundur të ulej në aerodrom, Bujar Mer-sini mendonte me vete zgjidhjen e këtij problemi të koklavitur.

Po. Rrotat nuk do të hapeshin sado që të mundahej ai, e, ndërkaq, nuk mund të fluturonte në qiell për një kohë të gjatë, sepse karburanti po mbarohej. Rreziku i një katastrofe ajrore po bëhej gjithmonë e më i qartë, gjithmonë e më i afërt. Ai vente drejt tij me shpejtësinë që harxhohet karburanti në ajër nga motorët reaktivë... Aty për aty rreziku ndodhej kudo në aeroplan. Ai fshihej prapa xhameve, në depozitën e karburantit, në atë dorezë të pabindur e kryeneçe, fshihej si një qenje dhelparake dhe e padukshme, por do të vinte me siguri një çast që të shpërthente me gjithë forcën e tij shkatërronjëse dhe atëhere...

Mos do të qe e nevojshme të hidhej me katalpultë nga aeroplani?..

— Jo — tha ai. — Ka ende kohë për këtë. Atij i dukej gjithnjë se mund të gjente një rrugëdalje për të shpëtuar të dy. Ai dhe aeroplani.

— Këtu treqind e treshi, — njoftoi ai tokën me radio. — Përpjekjet nuk dhanë asnjë përfundim. Rrotat vazhdojnë të mos hapen.

— Sa karburant ju ka mbetur? — pyeti udhëheqësi i fluturimit.

— Edhe dy-tre xhiro.

— Treqind e treshi — udhëroi ai — hidhu me katapultë! Aeroplanin drejtoje në një vend ku të mos ketë rrezik për popullsinë.

— Më lejoni të bëj edhe një përpjekje.

— Mirë. Kalo mbi aerodrom që t'i shohim rrotat edhe ne.

Ai buzëqeshi: «Kujtojnë se jam hutuar», mendoi dhe drejtoi aeroplanin mbi aerodrom. Shokët nuk i shihte, por e merrte me mend se si e ndiqnin ata nga toka fluturimin e atij aeroplani sakat, që nuk mund të hapte rrotat e krahëve dhe as të mblidhte rrotën e hundës që dukej si një këmbë e paralizuar.

— Gjithshka e qartë, treqind e tresh! — foli udhëheqësi i fluturimit me radio, me një zë atëror. — Pra s'ju mbetet gjë tjetër veçse të hidheni me katapultë.

2

— Katapulta!

Kjo nuk është kurdoherë zgjidhja më e mirë. Aeroplani, i ndarë nga piloti si një send pa shpirt, këputet e bie në ndonjë vend të shkretë, duke u bërë copë-copë, ndërsa piloti zbret ku të mundë, i mbajtur nga litarët e parashutës. Bujari kishte pasur raste të shihte aeroplanë reaktivë të rrëzuar, të ndryshkur dhe të shkallmuar, të shëmtuar, si mos

më keq, që fshihnin kokën, nën tokë, si të turpëruar nga një fluturim pa sukses, ndërsa shokët e tyre ngriheshin në qiellin, pa kufi. Jo, katapultat nuk ishte rrugëdalja. Mirëpo rasti ishte i tillë: ose të shpëtonte ai duke u hedhur me katapultë, ose të rrezikohej së bashku me avionin.

«Po sikur të shpëtojmë të dy?» mendoi.

«Në ç'mënyrë?» — iu përgjigj vetes.

«Duke u ulur me një rrotë»

«Po a është e mundur kjo?» — tha me vete sërishmi;

«E pse jo?»

«Ti e di, s'bëhet shaka me këtë punë».

«Sigurisht!»

«Përmbysja...»

«Edhe këtë e di!»

«Pra si do të bësh? — e pyeti vehten përsëri pa marrë ende ndonjë vendim. — Koha s'pret. Karburanti po mbarohet!

Ishte me të vërtetë në një gjëndje të vështirë. Në ballë, në buzë dhe kudo në trup, i rrodhën bula djerse. Para syve i doli Lili, diku në aerodrom, në shtëpi. Ajo e shikonte e vrejtur dhe gjithë ankth.

«Ç'thua ti, Lili? — pyeti ai.

Përfytyrimi vështronte dhe iu duk sikur i tha: Ti e di!..

Sa e sa heroizma njeh historia e aviacionit! Shumë prej tyre Bujari i kishte dëgjuar që në vogëli. Atëhere i dridhej zemra nga gëzimi kur e përfytyronte veten në vendin e pilotit. Merrni me mend një djalë fshatar, që edhe maqina ka parë rrallëherë, tek vështron fluturimin e një aeroplani të zakonshëm. Në ato çaste ai nuk është më në tokë. Gishti i këmbës i vritet te një gur, por ai e sheh

dhe e ndjen dhëmbjen vetëm atëhere kur aeroplani ka kaluar prapa maleve; vetëm atëhere ai ulet dhe vështron thuan e gjakosur.

Atje në fluturim, i erdhi në mend ky kujtim i fëmijërisë dhe, me gjithë gjendjen e vështirë, u mundua të buzëqeshte.

«Duhet ta shpëtoj patjetër aeroplanin», tha me vete dhe vendosi. «Do të ulem me një rrotë!..»

«Zjarri!, «Zjarri!» — thirri ai udhëheqësin e fluturimit. — Urdhërin tuaj për hedhje me katapultë e mora, por... më lejoni të bëj «ulje të detyruar»...

E ngriti avionin tepër lart, shtrëngoi rrypat fort pas trupit për të përballuar plogështinë, përpiu me sy atë qiell të kaltërt dhe pastaj u lëshua teposhtë dhe ai... ndjeu një tendosje muskujsh të fuqishëm dhe pastaj humbi i tëri në këtë zbritje.

Aeroplani reaktiv është një qenje me shpirt, një shok besnik për aviatorin që fluturon me të. Mjafton një lëvizje e dorezës dhe ai shkon nga të duash, majtas, djathtas, lart, poshtë, me shpejtësinë e zërit, si një predhë e drejtuar nga një dorë e sigurt. Po kësaj here s'donte të bindej. E megjithatë Bujari nuk ishte aspak i zemëruar me të për punën e rrotave. Kushedi se si e kishte hallin. Ai nuk e kishte lënë kurrë në baltë. Edhe kësaj here nuk duhej ta turpëronte. O sot, o kurrë!

Toka po afrohej. Ai e ndjente si nga larg uturimën e shurdhër të motorëve. Me trupin të anuar pak nga e majta vështronte poshtë me vëmendje të përqëndruar. Piloti parashikoi afërsisht vendin se ku do të ndalej aeroplani. Ai ngadalësoi shpejtësinë në minimum. Toka po afrohej me shpejtësi të llah-tarshme. Një çast dhe ai u ndodh mbi të. E kuptoi

menjëherë se ndjeu një tronditje të fortë që s'e kish provuar kurrë. Aeroplani, si kalë i azdisur, çau përpara me shpejtësi, duke e tërhequr trupin osh pas tokës, por nuk u përmbys. Hunda e tij ishte kthyer nga qielli me një farë këndi, sepse mungonin rrotat e krahëve. Përshkoi kështu i plagosur disa dhjetëra metra, që dukej se s'do të mbaronin kurrë, dhe u ndal.

Piloti u mbështet i lodhur pas kabinës.

Sikur ta linin, ai nuk do të dilte që andej për një copë herë. U permend vetëm kur ndjeu zërat e shokëve, që bëheshin gjithmonë e më të fortë. Aviatorët e duan shumë njëri-tjetrin. E nxorën jashtë, e puthën. Ai hapi sytë, pa atë qiell të kaltër dhe u gëzua. Do të fluturonin përsëri...

Njësi partizan u tërhoq me ngutësi në pyll, sepse në fshat pllakosën forca të mëdha gjermano-balliste. Lufta s'kishte mbaruar akoma. Përtej pyllit me bredha dëgjohej herë pas here krisma e thatë e një mitralozi dhe, në të rallë, të shtëna pushkësh.

...E shtrirë në mes të kashtës së një plevice, Reta mendohej të përfytyronte këtë tërheqje të shpejtë të shokëve. Mos ishte vlarë ndonjë prej tyre?.. «Ndofta» — mendonte ajo. Por komisarin e dinte që ishte gjallë. Ai nuk mund të vdiste. Ajo dëgjonte automatikun e tij që gjëmonte herë pas here me breshëri të shkurtëra dhe i dukej sikur kjo ishte përsëritja e fundit që i drejtohej asaj. «Mund të vdes» — tha ajo. Dhe përfytyroi sikur u hap me forcë dera e plevicës dhe brenda hyri një skuadër gjermanësh. «Dhe kjo mund të ndodhë» — tha, «por nuk më tremb». Ajo e dinte që shokët e saj ishin gjallë. Ata luftonin dhe e përsëhëdeshnin nga pylli me predha, me të shtëna pushke. Do t'ja merrnin hakën. Fundja jeta e saj nuk shkoi kot. Oh, sa gjëra mund të kujtonte Reta!.. Mësimet në lice, pedagogët fashistë që çirreshin për t'u mësuar italishten, këngët patriotike, demonstratat, përlëshjet e para me karabinierët, themelimin e Partisë Ko-

muniste, traktet e para, grupet ilegale në qytet, luftën partizane... Të gjitha këto ishin shumë, mjaftonin për të mbushur një jetë të tërë e, megjithatë, sikur të jetonte akoma, të luftonte akoma, të shihte ditën e bukur të lirisë, pastaj le të vdiste...

Si u ngrys, u hap me ngadalë dera e plevicës dhe në të hyri një burrë e një grua me kandil në dorë.

— O çupë, ku je, moj motër?..

Reta nuk u përgjegj, por ndjeu se ata të dy hoqën kashtën që e fshihte dhe e ngritën peshë me gjithë jorgan; pastaj e nxorën fshehurazi nga plevica dhe e futën në dhomën e zjarrit. Atje një plak i thinjur rrinte pranë vatrës dhe pinte duhan i menduar. Retën e shtrinë në një kënd dhe i thanë të mos bëhej merak. E zonja e shtëpisë i lëmoi flokët me dashuri dhe i pëshpëriti:

— Që sot e tutje do të rrish në shtëpinë tonë gjersa të shërohesh. Po të vijë njeri në shtëpi do t'i themi se je e motra e Selimit, e këtij këtu — tha për burrin e vet, — dhe je e sëmurë nga tifoja. Do t'u themi që ti as ha, as pi as flet, vetëm digjesh. Të kemi çuar te hoxha, të kemi bërë nuska, por s'ke përmirësim... Kështu të thuash edhe ti; ai atje është babai, — tha për plakun që rrinte pranë vatrës dhe pinte duhan. — Ti do të shërohesh dhe do të dalësh malit si sokoleshë. Hiç mos u mërzit, ë xhan i motrës? .. Dhe ajo e shikoi atë me dhëmshuri.

Errësirë...

Në fshatin e pushtuar nga armiku lëvizjet janë të ndaluara. Komandanti gjerman ka urdhëruar që të pushkatohet çdo njeri që del në orët e vona të natës. Vetëm era lëviz lirisht nga njëri skaj i fshatit në tjetrin, duke tundur degët e pishave që oshëtijnë lehtë. Patrulla gjermane ecën e heshtur në rrugët e fshatit dhe përgjon çdo lëvizje të dyshimtë. Jehona misterioze e halave të pishave u shtie frikën, e lehura e një qeni i alarmon; ngrehin më lart jakat e kapotave për t'u mbrojtur nga thëllimi dhe shtrëngojnë fort automatikët me qytë metalike, që u varen në gjoks.

Një oficer thatanik shkëputet nga patrulla dhe ngjit një fletushkë në derën e xhamisë. Era mundohet ta shqyejë cepin e saj të pangjitur, por gjermani nxjerr një pineskë dhe e fikson në vend. Mandej në dritën e elektrikut të dorës, ai lexon edhe një herë përmbajtjen e fletushkës të shkrojtur në dy gjuhë:

Urdhër:

Neni 1: Komanda gjermane ka të dhëna te sigurta se në fshat është fshehur një partizane e plagosur.

Neni 2: Urdhërohen gjithë fshatarët që ta zbulojnë dhe ta dorëzojnë te autoritet ushtarake.

Neni 3: Kundërvajtësit pushkatohen.

Komandanti i batalionit X alpin Hans Majer
d. v.

Patrulla gjermane largohet e heshtur në rrugët e fshatit, që nxijnë në mënyrë të frikshme. Duke kaluar sheshin e xhamisë, oficeri nazist vështron minarenë dhe arësyeton me vete: «Hansi s'ka për të nxjerrë gjë me këtë urdhër. Shqipëtarët janë trimë dhe nuk i tremben vdekjes. Unë i thashë se s'bëhet gjë me pushkatim, por ai ka teorinë e vet: «terror, terror, thotë. Vetëm ky i lan hallet në vendet e pushtuara». «Jo vetëm terror, i dashur Hans», thotë oficeri me vete sikur ta kishte komandantin përpara syve, «por edhe diçka tjetër — dhelpëri. . .» Duke vështruar minarenë, atij i bie ndër mend se popullsia shqiptare e këtyre anëve është mjaft fanatike. Atij i kujtohet se kolonizatorët anglezë, francezë, bile dhe vetë gjermanët i kanë përdorur gjerësisht për interes të tyre paragjykimet e popullsisë vendase në tokat e pushtuara. Ai e mbante veten për orientalist si dhe njohës të zakoneve dhe të dokeve të popujve ballkanikë. Kishte studjuar edhe mësimet e fesë muslimane, se kushedi, ndonjëherë mund t'i hynin në punë. . . Dhe ja tashi ajo minare, që i qëndron para syve si pikëçuditëse, i sjell ndër mend një ide djallëzore për zbulimin e partizanes së plagosur. «Nesër» thotë ai me vete, «duhet të mbledhim gjithë pleqtë e fshatit dhe t'i vëmë të betohen mbi kuran se nuk kanë fshehur njeri. Kjo provë mund të jetë për ta më e vështirë se çdo pushkatim. Do t'i flas Hansit për këtë. . .».

Të tre, si tre hije, kalojnë në rrugët e fshatit pa folur asnjë fjalë. Në shtëpitë prej guri të mbuluara me plloça të rënda, duket sikur nuk jeton njeri, por gjermanët e dinë: prapa dritareve me karnate prej druri, ku nuk depërton drita e kandilit,

prapa një dere që mbyllet me gërvimë, përtej atyre mureve të heshtura, prej guri, përgjojnë sy të mbushur me urrejtje. . .

* * *

Në shtëpinë e Selimit ka rënë qetësia. Njerëzit fytyrëvretur rrinë rreth e rrotull shtratit të Retës dhe vështrojnë si përpëlitet e plagosura në ethe. Një flutur i vjen rrotull qelqit të llambës me vajguri. Hija e saj e stërmadhe kalon mur mbi mur si një mendim ogurzi. Ajo është në kllapi, flet me vete, përmend komisarin dhe emra të tjerë partizanësh, mandej bërtet «përpara partizanë!», por zëri i saj s'ka fuqi.

«Po vuan çupa» — thotë plaku dhe tretet në mendime. «Lufta është e rëndë për burrat dhe jo mandej për gratë, por ç't'i bësh? Kanë ardhur kohë të këqia dhe askush s'mund të rrijë duarkryq...»

Plaku nxjerr qesen e duhanit dhe dredh një cigare. Tymi fjolla-fjolla i mbulon kryet e thinjura dhe ai vazhdon të bisedojë me vetëveten.

«Sa e gjatë qenka kjo natë dhe vuajtjet e saj s'kanë të sosur. Po e nesërmja ç'do të sjellë me vete? Një kob të ri apo një lajm të gëzueshëm? Sa pak gëzime që shohim në këtë jetë!» ankohet plaku dhe fillon të ëndërrojë për një mëngjez të kaltër pa brenga dhe halle, që të dalë nga dera e shtëpisë më qetë përpara dhe të shkojë me qejf në punë. «Pse të mos jetë kështu? Ç'dreq duan këta gjermanë, që vijnë nga anë e anës për të vrrarë e për të djegur?! Se mos u kemi vajtur ne në shtëpi të tyre!» Ja, plakut i dhimbset për partizanen e

plagosur si për vajzën e tij. Sa do të kishte qejf të kishte një vajzë si ajo, por ç'e do, s'deshi perëndia e i fali vetëm një djalë. — Një vajzë duhet për pleqëri» arësytonte plaku «se është më e dhëmshur nga djemtë. . .»

Kështu kaloi ajo natë e vështirë. Secili bluante me vete mendimet më të ndryshme, ndërsa e sëmura përpëlitej në kllapi. . . Nga jashtë dëgjohej trokitja ritmike e hapave të rojeve si një kërcënim ogurzi, që herë largohej dhe herë afrohej në terrin e natës.

Ndaj të gdhirë, në derën e shtëpisë u ndjenë disa të trokitura të lehta. Plaku ngurroi ta hapte derën gjersa nga jashtë u dëgjua një zë i njohur, që fliste duke pëshpëritur:

— O Selim! Selim ore!

— Ti, Faik, je, more bir? — pyeti plaku duke hapur derën pa zhurmë.

— Unë jam — u përgjegj i porsaardhuri duke hyrë në një kënd të errët të korridorit — ku është Selimi?

— Ja, aty — tha plaku duke i bërë zë të birit, — por ç'u mundove në këtë orë? . . .

— Kam një fjalë për të thënë, baba.

Kur erdhi Selimi, Faiku i foli me zë të ulët që të mos dëgjonte e plagosura:

— Njerëzit e ballit kanë kallëzuar se në fshat është fshehur një partizane e plagosur. Komandanti gjerman ka urdhëruar që të gjendet ajo dhe të pushkatohet para fshatit. Në mëhallën e Malit ka filluar kontrollimi i shtëpive. Së shpejti mund të vijnë edhe tek ju. . .

— Atëhere duhet ta fshehim të plagosurën.

— Patjetër, por kisha edhe diçka për të thënë...

— Folë! — tha Selimi i shtyrë nga një paraqendjenjë e keqe.

...Gjermanët kanë gjetur një marifet djallëzor për zbulimin e së plagosurës. Po s'doli gjë nga kontrolli, sot do të mbledhin gjithë fshatin e do të vënë pleqtë të betohen mbi kuran se s'kanë fshehur njeri.

Hej, dreqi i marrtë! — shkrofëtiu plaku. — Shih se ç'u shkon ndër mend të paudhëve. More bir, llaf i sigurt është ky? — pyeti me interesim, duke iu drejtuar Faikut.

— I sigurt, baba, na e tha një njeriu ynë që punon nën rrogoz me ballin.

— Hej, zot i madh, — u ankua plaku, — por tashti si t'ja bëjmë hallit? Po sikur të më vënë edhe mua të betohem mbi kuran? Për të treguar unë s'tregoj sikur të ma bëjnë mishin copa-copa, por them si t'ja bëjmë me allahun se jam plak njeri e me një këmbë në varr.

— Baba, — tha Faiku duke buzëqeshur lehtë në errësirë.

— Unë jam plak dhe i besoj perëndisë... — u përgjegj plaku.

— Ajo duhet të shpëtojë, baba.

— Po — tha plaku, — ajo duhet të shpëtojë.

Djallëzia e gjermanëve e vuri plakun në rrugë kryq. Pra, armiku qenkërka jo vetëm i egër, por edhe dinak. Të tregonte për partizanen e plagosur, as që i shkonte ndër mend. Më mirë të vdiste! Të mos tregonte kishte frikë nga allahu. Hoxha kishte thënë kushedi sa herë se për gjynahe të tilla zoti të dërgon në xhehmem. Kështu këndonin edhe

ato qitapet e vjetra të xhamisë me kapakë dhe fletë të lerosura. Tek mendonte xhehnemin, i dilnin para syve kazanë me serë, avuj përvëlonjës, që e mundonin gjithë jetën e përtej varrit, shejtanë të shëmtuar, që i vinin rrotull dhe i merrnin shpirtin.

«Allah! Allah» filloi të lutej plaku sikur të kishte zotin aty pranë. «Ti e kupton që unë s'kam si të tregoj për atë vajzën. Është gjynah prej përrëndie. Gjermanët, po e gjetën, do ta pushkatojnë. Më mirë të më vrasin mua që e hëngra kullotën se atë. A nuk është kështu? Ajo është aqë e re! Akoma s'i ka mbushur njëzet pranverat dhe më të ka rrëmbyer pushkën dhe lufton kundër hasmit si një burrë e shkuar burrit. Hë, ç'thua ti, si të bëj?» Plaku humbi në një vështrim të pacaktuar.

* * *

E nesërmja gdhiu e vrenjtur dhe e ftohtë si asnjëherë tjetër. Fshati N., përtej maleve të Kolonjës, nuk do ta harrojë lehtë atë mëngjez të vrenjtur vjeshte, kur u mbloodh i tëri te sheshi i xhamisë. Te porta e saj, si një lajmërim vdekjeje, varej urdhëri i komandantit të batalionit X alpin Hans Majer. Pleqtë vështronin ushtarët armiq me zemërim të heshtur, fëmijët qanin në prehrin e nënave, kurse të tjerët shihnin plot shpresë malet përreth, ku strehoheshin partizanët.

Gjermanët, nën helmetat e hekurta, shihnin me mëri këtë turmë të pabindur, e shtynin me qytat e automatikëve për t'u mbledhur më shpejt dhe diç bërtisnin në atë gjuhë të huaj, që ngjiste

si e lehura e qenve. Së fundi erdhi komandanti i tyre, një burrë i shëndoshë mbi dyzet vjet, me një fytyrë të rreptë dhe të hequr. Dy hapa nga prapa i vinte ai oficeri thatanik me syze të florinjta, që vari urdhërin në derën e xhamisë si dhe dy ballista me revole në brez, që heshtnin gjithë respekt. Prapa tyre zvarrisej hoxha i fshatit, i zverdhur si meit me një qitap të vjetër nën sjetull.

— Po ti çdo me ta, efendi? — e ngacmuan dy të rinj, kur u shkoi pranë. Ai u hodhi një vështrim me bisht të syrit, që shprehte frikë dhe ndrojtje dhe eci më tutje për të mos mbetur shumë prapa se, kushedi, i thoshin gjë gjermanët! Mbi veshë i binin si purteka shpotitë e bashkëfshatarëve:

— Mos do na bëhesh zabit, hoxhë efendi?...

— Qerrataj, e ka qejf uniformën!...

Kur mbrijtën në mes të sheshit, komandanti diç u tha ushtarëve gjermanisht dhe ata pushuan së shtyri turmën, por u radhitën prapa saj në formë rrethi, të gatshëm për çdo të papritur.

— Ne e dimë ku ndodhet partizanja e plagosur, — e mori fjalën ai oficeri me syze, — por duam që këtë ta nxjerrë vetë fshati.

— Por kur e dini pse na mundoni kot, bre... — qesëndisi me zë të ulët një fshatar shakaxhi aty nga mesi i turmës.

Ndërsa përkthenjësi jepte fjalimin e oficerit në gjuhën shqipe, komandanti i batalionit vështronte me vëmendje fytyrat e parrojtura të fshatarëve për të zbuluar fajtorin. Ato, si më parë, rrinin të heshtura dhe shprehnin vetëm urrejtje të papërmbajtur, kurse sytë, ah sytë... (komandanti i batalionit X alpin Hans Majer do të kishte qejf

t'ja u nxirrte të gjithëve me bajonetë) vështronin me një ironi të hollë kolegun e tij.

Fjalimi i oficerit gjerman ishte i shkurtër, por në të gjeje edhe premtime se do të jepeshin të holla dhe ushqime për atë që do të dorëzonte partizanin e plagosur edhe kërcënime se do të pushkatoheshin njerëz, se do të digjeshin shtëpi dhe do të konfiskoheshin bagëti në rast se nuk e nxirrin ata vetë.

— Ku e keni fshehur, nxirreni! — urdhëroi me kërcënim oficeri nazist, duke shikuar me egërsi fytyrat e fshehura të fshatarëve.

— Zoti oficer! — e mori fjalën njëri nga pleqtë e fshatit, duke vështruar gjermanët gjakftohtë. — Ne fshatarët jemi ca kokë trashë dhe s'para marrim vesh nga politika. Po ta kishim atë partizanin që thua zotrote, do ta kishim dorëzuar patjetër, se ç'na duhet ne të ngatërrohemi me këto punë; por kur s'e kemi ç'të bëjmë? Ja, ju kontrolluat vetë shtëpitë tona dhe s'gjetët gjë. Po të qe, do ta kishit gjetur, se s'është ndonjë majë gjilpëre.

Kur ja përkthyen fjalët e tij komandantit të batalionit, ky buzëqeshi me ligësi dhe foli me zëmërim:

— Mos na u shitni si shënjtore! Ne e dimë se dy-tre nga ju janë me partizanët. Gjatë kontrollit në shtëpinë e... atij (si ja thonë emrin?) — pyeti kolegun me syze, që e kishte përbri.

— Veli.

— ... Në shtëpinë e Veliut kemi gjetur komunikata. Djalin e arrestuam dhe së shpejti do të pushkatohet për bashkëpunim me komunistët. Dhe ti, plak, që hiqesh si i shenjtë, dhe ti je një partizan...

Selimi me të atin rrinin ca si mënjanë grumbullit të njerëzve pranë gjoksit të një ushtari gjerman dhe ndiqnin me vëmendje zhvillimin e ngjarjeve. Kaloj kohë dhe gjermanët s'po nxirrnin gjë nga fshati, as me të mirë, as me të keq. Mbetej vetëm guri i fundit — kuran.

— Hajde ti, hoxhë! — i tha atij njëri nga ballistët. — Dil aty në mes të sheshit dhe vëri të betohen mbi kuran!

Hoxha u hutua si kurrë ndonjëherë. Bëri disa hapa përpara dhe u ndal. Këmbët i dridheshin dhe duart e fishkura nga pleqëria mezi e mbanin kuranin, që i rëndonte si plumbi.

— Hajdeni! — pëshpëriti duke vështruar fshatarët me sy të mjegulluar. — Kush do të vijë të betohet i pari?..

Asnjëri nuk lëvizi nga vendi gjersa komandanti gjerman urdhëroi ushtarët t'i çonin një e nga një. Para hoxhës kaluan gati gjithë moshatarët e plakut: Ziçja, Ramadani, Suati... Pas dy tre vetash i vinte radha atij.

Selimi iu afrua të atit, e vështroi në sy dhe i pëshpëriti:

— Mbahu si burrat, baba!

Plaku nuk priti që ta çonin ushtarët para hoxhës, por shkoi vetë. Atje, para kuranit të shënjtë që e kishte puthur kushedi sa herë, duke iu lutur për një fat më të mirë në jetë, u ndal dhe, duke vështruar hoxhën me përbuzje, tha:

— Betohem se nuk kam fshehur njeri as unë dhe as njerëzit e familjes.

I

Keni parë ndonjëherë si përplasen zogjtë në kafaz?

Fluturimi i tyre i shkurtër ndërpritet te telat. Ata ngjiten lart, zbresin poshtë, mundohen edhe një herë të dalin, por më kot. Rifillojnë edhe një herë nga e para. Përsëri më kot. Para tyre qëndrojnë shufrat e holla prej teli, të cilat u duken krejt të pashpërthyeshme.

Elida lëvizte e shqetësuar. Herë pas here psherëtinte.

Kur mbeti vetëm në zyrë, mori dorezën e telefonit dhe i ra një numri të njohur.

— Alo, jam unë.

Ai u përgjegj menjëherë. Çapkën, i qeshur si kurdoherë, u përpoq edhe kësaj here të bënte shaka, por nuk vazhdoi, sepse ajo mezi nxirrte fjalët nga goja.

— Alo, Elida, — pyeti Kristaqi i çuditur, — s'qënkërke në formë sot. Si e ke hallin?!

— Kristaq, dua të them diçka me rëndësi. Në ç'orë do të takohemi sonte?

— Ashtuuu?!... — parandjeu diçka të papëlqyer. — Sonte kisha një punë, por... mirë, fundja takohemi, në orën e caktuar si zakonisht. Vëndin e di.

— Jo, më heret.

— E përse më heret — u përgjegj ai.

Elida vajti disa minuta përpara. Kristaqin nuk e gjeti. E dinte se ai ishte i përpiktë dhe do të vente në orën e caktuar. U mbështet te trangu i një ekualliptusi dhe priti.

Një minutë, dy, tri.

Elida e dinte se ai porsa të vente, do t'i hidhte krahun menjëherë, do ta përqafoje lehtë në errësirë dhe do të ecnin më tej. Pastaj do fillonin bisadat pa mbarim. Por ç'e do!... Ato zhvilloheshin gjithmonë në errësirë. Kjo nuk i kishte pëlqyer asaj.

Ah kjo mbrëmja! — tha ajo. — Gjithmonë në këtë kohë, gjithmonë në errësirë.

Tek mendohej kështu, dy krahë të fuqishëm e kapën papritmas nga prapa. Ajo u tremb, desh klithi, ktheu kokën menjëherë nga prapa dhe u qetësua kur njohu Kristaqin.

Ai, sikurse e priste Elida, e përqafoi lehtë-lehtë, i hodhi krahun dhe u nisën. Elida kopsiti kabardinën, rregulloi në kokë shaminë e bardhë prej nailoni dhe u mbështet në krahun e tij.

Ecën më tej.

Errësirë.

Mbrapa tyre u lëkundën dritat e një veture. Rrezet e forta, që depërtuan nëpër terrin e natës, ndriçuan zbetë kodrën përballë, pastaj, gjithmonë duke u lëkundur, u kthyen djathtas dhe u zhdukën.

Qetësi.

— Ç'kishe për të më thënë Elida? — pyeti ai dhe, me që ajo nuk po fliste, vazhdoi duke para-

ndjerë diçka të papëlqyer, të cilën donte ta mësonte sa më parë.

— Më parë unë duhej të të lutesha për një takim, kur befasi ti më thirre me urgjencë. Folë, Elida! Ç'ka ndodhur?..

Ajo nuk fliste. Ecnin ngadalë si dy hije, duke mbajtur një farë distance. Më tej siluetat e një çifti u dukën në errësirë.

Çifti u afrua dhe të dy të shkujdesur kaluan në zonën e ndriçuar të rrugicës dhe u larguan nëpër terr.

— Sa e re ajo vajza! — tha Kristaqi.

— Edhe dashuria e tyre është e re — shtoi Elida.

Ai heshti. Kishin hyrë në një pjesë të parkut, ku kishte plot pisha të larta. Aty pranë tyre nuk dukej asnjëri. Nga larg, përmes degëve të pishave, mezi depërtonte drita që lëshonin llambat e rrugëve të qytetit. Elida u mbështet pas trungut të një peme dhe me zë të dredhur nga emocionin tha:

— Dëgjo Kiço, unë jam shtatzanë.

— Si! .. — pyeti ai dhe ngriu në vend. Ndoshta nuk e kishte dëgjuar mirë, ndoshta nuk ishte e vërtetë! Por jo! Ajo po qante dhe thellë në veten e vet ndjeu një tmerr që nuk e kishte provuar kurrë.

— Je e sigurt — tha ai. Vështrimi i tij ishte bërë më i mprehtë se ndonjëherë tjetër, lëvizjet më të prera.

— E sigurt — tha ajo përmes ngashërimeve.


Ai kryqëzoi duart në gjoks dhe vështroi qytetin e gjerë dhe të pafund ku vezullonin dritat. E ndjeu veten jashtëzakonisht ngushtë. I dukej se

nga qielli po binte një dëborë e shtruar dhe e butë, që po e ngrinte, po e mpinte dhe po e bënte kallkan.

Zbritën nga shkallët masive të universitetit dhe hynë në rrugica. Elida ishte e dërmuar. Krahët i vareshin poshtë të pafuqishëm, kurse në sy i ndrisnin akoma dy pika loti. Kristaqi i vente nga prapa. Nuk flisnin asnjë fjalë.

Ata ecnin kështu plot mendime, ecnin pa ditur se ku... Dhe kështu u ndanë. Në formën e dy hijeve, që largohen kokulur në errësirë...

Kur Elida ishte ndarë prej tij dhe kishte arritur tek kthesa në fund të rrugës, ai mendoi të



vraponte tek ajo, t'i shpjegonte se s'kishte punë me të, se që atë ditë nuk do të takoheshin kurrë, por instikti i vetëmbrojtjes e ndali në vend.

«Jo — tha me vete. — Mos do të provokosh lot, psherëtima, që të shohin njerëzit, dëshmitarët e nesërm?... Dhe thellë në veten e tij u krijua imazhi i një procesi gjyqësor sensacional: Njohje atësie!

«Po prit pak. Kush na ka parë ne?»

Nga kjo kllapi e zgjoi sirena e trenit, që vërshëlleu nga skaji tjetër i Tiranës.

Fiu!.. Fi!..

Sirena u përsërit edhe një herë.

Fi!..

Dhe atij i dukej sikur po nisej një tren i rëndë, me rrota të mëdha prej çeliku, i cili gulçonte nga pesha tepër e madhe që duhej të tërhiqte dhe herë pas here lëshonte shpërthime avulli:

Çaf-çuf! Çaf-çuf! Çaf-çuf.

I dukej sikur ky tren e shtypte me rrotat e tij tepër të mëdha, ashtu sikurse bluan kokrriza rëre mbi binarë dhe i bën pluhur.

Kokulur, me mendime të frikshme, u nis për në shtëpi.

2

Gjykatësi e lexonte ndofta për të dhjetën herë atë kërkesë padie dhe për të dhjetën herë përplaste duart në tavolinë i pakënaqur.

Ishte korrik dhe bënte vapë. Nga dritarja e zyrës e hapur me të dy kanatet vinte një afsh i nxehtë vere, zhurmë maqinash, trokitje takash mbi trotuar.

Dy ndihmësgjyqtarët e dinin përse shqetësohej ai. Po gjykonin një padi të vështirë me objekt njohje atësie. Në seancën e parë me dyer të mbyllura i padituri e kishte mohuar krejtësisht atësinë e fëmijës. Nga ana tjetër, provat në mbështetje të padisë ishin krejtësisht të pamjaftueshme. Disa dëshmitarë i kishin parë të shoqëroreshin në rrugë, në kinema, në orët e vona të mbrëmjes. Vetëm kaq. Po bindja e brendshme juridike socialiste?! — do të thotë dikush. Mirëpo kjo nuk mjafton. Pa prova nuk mjaftonte as bindja e brendshme e gjykatësit dhe as ajo e dy ndihmësgjyqtarëve, të cilët i mundonte vazhdimisht pyetja: «Përse Elida paditi pikërisht Kristaqin?!».

— S'ka dyshim — tha njëra nga ndihmësgjyqtaret që ishte edhe vetë nënë, — se Kristaqi është ati i fëmijës. E ç'interes do të kishte Elida të kërkonte atësinë e fëmijës nga një njeri që nuk është ati i vërtetë!... Me sa di unë, ajo nuk është nga ato vajza, megjithëse, ç'është e vërteta, në këtë çështje është treguar e papjekur.

— Ashtu mendoj edhe unë — tha gjykatësi shkurt.

— Atëhere përse lëkundeni ju? — pyeti ndihmësgjyqtarja me interesim.

— Duhet prova patjetër — shpjegoi ai. — Ne nuk mund të japim një vendim të bazuar mbi supozime, sado të sigurtë që të jemi për këtë.

— Atëhere si t'ja bëjmë?

— S'di ç'të them — u përgjegj ai mendueshëm, duke mbledhur supet i pakënaqur.

— Po le ta shchim problemin me interesim — tha ndihmësgjyqtarja tjetër, që gjer atëhere kishte heshtur. — Përse Kristaqi mohon atësinë e fëmijës?..

— Do t'ju tregoj një rast nga praktika gjyqësore, — tha gjykatësi mendueshëm. — Një i paditur e mohoi nga fillimi deri në fund atësinë e fëmijës. Pavarësisht nga kjo, atësia u njoh me vendim gjyqësor sepse kishte prova të mjaftueshme. Kaluan vite dhe vajza u rrit. Ajo u bë një pioniere e shkëlqyer. Atëhere i ati filloi të interesohej për të. E merрте në shëtitje, i çonte dhurata, e takonte herë pas here.

Meqë e njihja qysh nga seanca gjyqësore, e pyeta një ditë: «Përse e mohove atëhere atësinë e fëmijës dhe u solle aqë keq kundrejt nënës së saj?» Mbeti ngushtë dhe m'u përgjegj me sinqeritet: — «S'di ç't'ju them, shoku gjykatës. Kam gabuar rëndë dikur. Atëhere isha një djalë i papjekur dhe më dukej si diçka jashtëzakonisht e papëlqyer të bëhesha menjëherë baba...»

— E dini, shoku kryetar? — tha përsëri njëra nga ndihmësgjyqtaret. — Do të ishte mirë të bisedonim një herë shtruar me të paditurin. Ndoshta ai ndryshon qëndrim ndaj fëmijës dhe Elidës.

— Kemi biseduar — tha gjykatësi, — por ai mohon në mënyrë kategorike që të jetë ati i fëmijës.

— Po Elidën e ka dashur vërtet? — pyeti përsëri ndihmësgjyqtarja dhe shtoi: — Më falni se ndoshta bëj një pyetje pa vend.

— Më duket se po — tha gjykatësi dhe në

buzë i ndriti një buzëqeshje e hollë. — Ai vetë nuk e thotë këtë, bile mohon krejtësisht që të ketë pasur me të raporte dashurie, por padashur ai tradhëton vetëveten: për Elidën nuk flet ndonjë fjalë të keqe, sikurse ka ndodhur në raste analoge me të. Po ta vësh re me kujdes në vështrimin e tij ndaj Elidës mund të dallosh një farë ndjenje, që tregon se ata të paktën janë dashur dikur. . .

— Shumë mirë — tha ndihmësgjyqtarja me entuziazëm, — kjo mund të jetë një bazë për ribashkimin e tyre.

— Më falni — tha ndihmësgjyqtarja tjetër. — Të mos i ngatërrojmë gjërat. Ne duhet të zgjidhim çështjen e atësisë së fëmijës të shkëputur nga martesja e paditëses me të paditurin. Martesja mund të jetë e mundur, mund të jetë edhe e pamundur për arsye të ndryshme, kurse atësia duhet të njihet patjetër. Edhe paditësja këtë kërkon.

— Edhe unë jam dakord — shtoi gjykatësi — që këto janë dy çështje të ndryshme, por nuk janë të shkëputura. Ato mund të ndihmojnë njëra-tjetrën.

Në seancën e dytë dyert e sallës u mbyllën përsëri. U lejuan të merrnin pjesë vetëm prindërit e Elidës. Nga Kristaqi nuk kishte ardhur njeri.

Elida kishte zënë vend përballë Kristaqit dhe u përgjegjej me ndrojtje pyetjeve të gjykatësit. Kur fliste, më shumë i drejtohej kryetarit dhe rrallë, shumë rrallë, vështronte nga Kristaqi me një vështrim qortonjës dhe akuzonjës. Kishte veshur një bluzë të bardhë, që dukej sikur i hidhte dritë fytyrës së saj të hijshme si dhe një fund teritali ngjyrë kafe.

Ai rrinte kokulur në vendin e të paditurit.

Kishte një fytyrë të hequr dhe simpatike, një lëkurë të rreshkur e të pjekur nga rrezet e diellit. Nga emocioni dukej pakëz i zbetë dhe herë pas here bënte lëvizje gjithë nervozizëm. Atë ditë kishte veshur një kostum ngjyrë gri, që dukej sikur nuk i rrinte mirë, sikur nuk ishte për trupin e tij për shkak të lëvizjeve të herpashershme dhe të qëndrimit jo të lirshëm. Kokën e mbante ulur zakonisht ose të kthyer nga salla. Vështrimi i tij shëtiste mbi ndënjëset e stolave që ishin bosh dhe ai mendonte se sa e tmerrshme do të ishte sikur në ato stola të ishin ulur njerëz, që do të përpinin hollësiat e atij gjyqi dhe do t'i komentonin për ditë me radhë. Mandej ai shikonte matanë dritareve, ku tundeshin nga flladi disa degë pemësh dhe fluturonin zogj.

Nganjëherë vështronte edhe ai në drejtim të saj, por fshehurazi, kur Elida nuk e vinte re.

Elida shpjegonte se si e kishin filluar dashurinë, ku ishin takuar, premtimin që i kishte bërë ai për martesë... Ajo shpjegonte lirshëm, ashtu sikurse flet njeriu kur thotë të vërtetën, kurse ai rrinte si i ngurosur në vendin e të paditurit. Mbi ballë dhe në pëllëmbët e duarve i kishin dalë pikëza djerse. Dukej i hutuar, thuajse nuk e kishte mendjen aty. Përgjigjej shkurt. Edhe atij i kujtohej se ashtu kish ndodhur, sikurse shpjegonte Elida, por ai mohonte, ndaj edhe ngatërrohej kur fliste...

Gjykatësi e kuptoi se kështu nuk mund të vazhdohej më tej. Seanca u mbyll. Ata u ngritën.

Kur u kthyen në zyrë për të biseduar rreth

çështjes, gjykatësi iu drejtua dy ndihmëseve të tij dhe i pyeti:

— Ç'mendim keni ju?

— Unë mendoj— tha njëra prej tyre që ishte kryetare e komitetit profesional në ndërmarrjen e vet, — që çështjen ta shtrojmë për diskutim para kolektivit të uzinës, ku punon i padituri. Kolektivi është gjykatësi më i mirë dhe ndofta do të na sqarojë shumë gjëra.

Ata u panë me njeri tjetrin dhe vendosën.

3.

Ishte mesditë dhe qyteti buçiste nga gjallëria. Vetëm ai ecte kokulur, i zhytur në mendime të thella. Ai nuk dëgjonte as boritë e automobileve, as ecjen e njerëzve përreth tij, as të qeshurat e gëzuara të fëmijëve, që luanin pranë mureve të pallateve.

Tek ecte kokulur në trotuar, para tij kaloi Elida me disa njerëz, që e shoqëronin dhe me fëmijën në krahë. Ajo, sigurisht, nuk e përshëndeti, dhe kaloi në trotuar me atë ecjen e saj që ai e njihte aq mirë. Nga prapa ai vështronte shpatullat, krahët, format e flokëve, dëgjoi timbrin e zërit të saj, i cili kishte diçka, të njohur, të afërt dhe intim. Për një çast iu duk disi jo normale që ai të mos fliste me Elidën, diçka e pamundur, e jashtëzakonshme, por ky ishte realiteti.

Ai ecte mengadalë dhe mendonte se «betejën» e parë pothuajse e kishte fituar. Gjyqi nuk kishte

prova që të vërtetonte se ai ishte ati i fëmijës. Por në ndërgjegjen e tij diçka po ndodhte. — Po — tha. — Edhe sikur të mos e dinte njeri tjetër këtë punë, e di Elida, do ta mësojë fëmija kur të rritet. Atë e dinte ai vetë dhe ndërgjegjja e tij po qe se kishte të tillë.

Mbresat e asaj dite i ngatërroheshin me kujtimet e së kaluarës. Elida në gjyq i solli ndër mend skena nga koha e dashurisë së tyre, të cilat ai me dhunë ishte munduar t'i largonte nga kujtesa, t'i dëbonte, t'i mohonte si para trupit gjykues ashtu edhe para vetëvetes. Mirëpo ato nuk zhdukeshin aqë lehtë dhe ai e shihte veten pranë Elidës në ditët e para të dashurisë. Ato kishin qenë ditët më të bukura... I kujtohej njohja në plazh, takimet e para. Kristaqi atëhere linte punën në uzinë dhe prishte sa të ngrysej. Në orën e caktuar ata të dy ishin te eukaliptusi i tyre, te stoli i tyre... Vendet, ku takoheshin më shpesh, kishin marrë për ta një kuptim më intim, prandaj edhe i quanin të vetat. Tashti që ai i kishte mohuar ato ditë, i dukej se edhe eukaliptusi i tyre, edhe stoli i tyre e akuzonin, e qortonin!.

Ndërkaqë Elida me njerëzit që e shoqëronin kishte ecur përpara. Edhe pak edhe do të zhdukej nga sytë, kurse ai kishte mbetur prapa dhe zvarritëj trotuarit. Një zë i brendshëm i thoshte të shpejtonte, t'i arrinte dhe t'i kërkonte të falur Elidës për gjithshka që kishte ndodhur midis tyre, se vëndi i tij ishte pranë saj dhe fëmijës së tyre, por ai nuk guxonte të bënte asnjë hap.

«Si ndodhi që arritëm deri këtu?» mendoi me vete.

Dhe iu kujtuan ato ditë të tmerrshme, kur Elida kishte mbetur shtatzënë.

Qysh atëhere kishte filluar prishja e tyre...

Të gjitha këto i kujtonte atë ditë tek kthehej në shtëpi dhe bënte, pa e ditur njeri, gjyqin e vetëvetes.

Së shpejti do të mblidhej kolektivi i uzinës, ku punonte, për të shqyrtuar çështjen e tij. Ai e merrte me mend se si do të diskutonin shokët e punës.

Duke écur, arriti në një rrugëkryqe. Ku të shkonte? Edhe rrugët, edhe sheshet e mbushura plot me njerëz ishin shqetësuese për të, sepse i dukej sikur e qortonin njëzëri:

«Ti, ti je fajtor për gjithshka!»

4.

Ai ishte një gjyq i vërtetë; gjyqi i masës: i rreptë, i drejtë.

Kristaqi kishte zënë një vend në cep të sallës që të mos binte në sy, por vështrimet, vinin nga vinin, dhe mbi atë drejtoheshin; për atë flisnin edhe ata qindra veta në atë sallë të madhe sa një sallë kinemaje, që gumëzhinte, gumëzhinte...

Në gjykatë ai e kish ndjerë veten disi më të qetë se e dinte që ajo nuk kishte prova, por këtu, në mbledhjen e kolektivit, ishte ndrydhur sa një grusht, ishte zbehur dhe dukej sikur kishte të ftohtë, megjithëse njerëzit rreth e rrotull sa nuk pëlçisnin nga vapa.

Punëtorët po hynin njëri pas tjetrit në sallë;

dikush qeshte me shoqen që kish pranë, dikush bisedonte, të tjerët hynin në sallë me rroba të punës gjithë vajra dhe uleshin të shkujdesur në stola. Salla po mbushej plot dhe së shpejti do të fillonte mbledhja.

Të të vështrojnë qindra sy nuk është gjë e lehtë. Të të dënojnë qindra sy është e tmerrshme.

Ke përpara gjithë kolektivin.

Në mëngjez në orën gjashtë, kur hyn te dera e uzinës, ti i përshëndet ata, u thua «Mirë mëngjezi» dhe ata të pyesin «Si u gdhive?». Të shohin si punon dhe të rrahin shpatullat kur punon mirë, të lavdërojnë, të nderojnë, të duan... por, po ata shokë të qortojnë kur gabon. Herën e parë apo të dytën mbase nuk të thonë gjë, vetëm të shikojnë me rreptësi, por të tretën të kërkojnë llogari, të thonë «Ndal!». Dhe atyre syve s'ke si t'u shpëtosh, se gjithshka të mirë apo të keqe e ke bërë në kolektiv...

«Gjyqi» filloi, dhe ai e ndjente veten të dërmuar plotësisht. Përreth ishin shokët e tij të punës.

«Ata do të ngrihen të flasin» — mendoi ai dhe i dukej sikur ai treni i frikshëm dhe i tmerrshëm, që do ta dërmonte, po i afrohej me rrapëllimë zhurmash të çelikta, me shfryrje avulli, me fishkëllimë sirenash, me goditjen e tij të tmerrshme dhe të paevitueshme si një domosdoshmëri.

«Po fundja përse të ndodhin gjithë këto? — pyeti veten gjakftohtë. — A mos e kam gabim unë që mbaj këtë qëndrim?..»

«Gabim e ke, sigurisht! — iu përgjegj një zë i brendshëm — bile të të vijë turp nga vetëvetja...»

«Mos më ka ndonjë faj Elida?»

« Jo. »

« Shokët, kolektivi? »

« Jo! Jo! »

« Atëhere? . . . »

« Ti, ti je fajtor për gjithshka! . . . »

« Ta zëmë se është ashtu dhe unë do të bëj autokritikë para kolektivit, por a do të më besojnë, a do të më falë Elida? . . . »

« Ajo është tjetër punë. Ndoshta nuk të fal. »

Ndërkaqë mbledhja kishte filluar dhe punëtorët vazhdonin diskutimet njëri pas tjetrit. Të gjithë e dënonin qëndrimin e tij, kurse ai s'dinte si të vendoste, lëkundej.

Në fund, kur gjithshka u sqarua plotësisht, kur s'kishte më rëndësi për sqarimin e çështjes në do të thoshte ai «po» ose «jo», u ngrit dhe, me zë të dredhur nga emocioni, tha shkurt:

— Ju keni të drejtë, shokë. E vërteta është ashtu sikurse thatë ju. E pranoj që kam bërë gabim dhe ju kërkoj të falur të gjithëve, edhe Elidës. . .

Përnjëherësh në sallën e madhe të mbledhjeve të uzinës u bë qetësi. Dukej sikur njerëzit, për një çast, nuk merrnin as frymë, vetëm dëgjonin.

Këtë qetësi e prishi zëri i një plake, që u ngrit menjëherë më këmbë dhe tha e emocionuar:

— Ti duhet të martohesh me të. Hajde, thuaje këtë para kolektivit!

Ai s'dinte ç'të thoshte. I dërmuar plotësisht, ai ndoshta do ta pranonte edhe këtë, por i vinte turp nga Elida. Ai ishte sjellë aqë keq ndaj saj. . .

Ndërsa ai mendohej se si do të përgjigjej për këtë pyetje me rëndësi, nga radhët e para të sallës u ngrit menjëherë Elida dhe tha:

— Falënderoj kolektivin tuaj që më ndihmoi për zbulimin e së vërtetës dhe njohjen e atësisë së fëmijës. Vetëm kaqë, nuk kërkoj më tepër. Sa për martesën unë duhet të mendohem mirë; me qëndrimin që ka mbajtur ai, më ka ofenduar thellësisht.

NË DITËT E FUNDIT TË LUFTËS

Mbasi mori urdhërin e nisjes, Nasi përgatiti me nxitim motoçikletën dhe iu lut Teftës të bëhej gati sa më shpejt se do ta çonte te shkëmbi i Kavajës, ku ishte dislokuar batalioni i saj.

— Nasi, të lutem më prit një minutë sa t'i shpie çantën Violetës dhe erdha.

— Hajde shpejt se s'kemi kohë.

— Prit një çikë de!.. — tha Tefta me një theks të pastër korçar, duke e vështruar me dashuri.

— Do të shkojmë bashkë, ë?

— E pra, bashkë — u përgjegy ai gjithë seriozitet.

— Me motor?

— Sigurisht!

— Mbrapa do të hypi unë, Nasi?

— S'do mend! Oj, kjo! Pse, ç'kujton ti, mbi serbator?! Po hë, pra, shpejt, Tefta, ç'më vështron ashtu sikur s'më ke parë? Ta dish se ika dhe hajde me se të duash pastaj..

— Uh, sa i lig që je, mo i zi! — tha Tefta dhe shtyu portën prej hekuri, ku bënte rojë një partizan. — Ja, sikur kam ardhur!

Nasi e vështronte tek vraponte në shesh dhe e përfytyronte të veshur nuse, me flokë të krehur

me kujdes. Sa e bukur do të dukej Tefta! Edhe kësh-tu me veshje ushtarake ajo ishte simpatike. Rro-bat partizane i shkonin për bukuri. Xhakaventoja dhe bustina me yllin e kuq sikur ishin prerë për trupin e saj. Vetëm pantallonat i rrinin pak të gje-ra. Me ato këpucë të rënda ushtarake dukej sikur e hidhte hapin me vështirësi. Megjithatë vraponte. Edhe pak i duhej për të arritur te komanda e bri-gadës, që ishte vendosur te kazermat e italianëve.

Nasi nderi motorin dhe po priste sa të kthehej Tefta.

Ishin të fejuar. Në mal kishte raste që nuk shiheshin as dy-tri javë rrjesht në kohën e opera-cioneve, por prapë e ndjenin veten afër njëri-tje-trit, sepse luftonin së bashku. Lufta mbaroi: erdhi dita kur do të ktheheshin në shtëpitë e tyre, në fi-llim Tefta, pastaj ai. Martesa do të qe e shpejtë. Me t'u kthyer Nasi, do të martoheshin me ç'të ki-shin.

— Ç'mendon ashtu? — e pyeti Tefta nga pra-pa.

— Unë?.. Eh, po mendoja dasmën.

— Atje të rri mendja. Nuk martohem me ty, e more vesh?.. — i tha me të qeshur.

— Aman, martohu! Kujton se unë plasa për ty...

— As unë për ty...

— Unë do të gjej një tjetër — i tha Nasi, duke e vështruar thellë në sy.

— Kurse unë e kam gjetur.

— Do të na ftosh për dasmë.

— Ndoshta!.. Je shofer i mirë, për veturën tonë.

— Bobo, qenka pasanik — tha Nasi duke qe-

shur, dhe shtoi: — Veç kam frikë se mos fluturojë nga vetura tashti pas luftës.

Tefta po qeshte me gjithë shpirt, kurse ai gjithë seriozitet shtoi:

— Ka mundësi, «zojush», të hypni këtu prapa?

U nisën. Motoçikleta italiane nuk ishte aqë e re, por punonte mirë. Pasi dolën në rrugën e asfaltuar, që shkonte paralel me bregun e detit, Nasi e shtoi shpejtësinë. Shigjeta e kilometrazhit lëvizte midis numrave 60 dhe 70. Teftës i dukej sikur fluturonte. Xhakaventoja partizane i gufonte nga era, kurse ajo kapej gjithmonë e më fort pas Nasit.

Rem agai dhe miku i tij Dulla kishin zënë pritë buzë xhadesë. Kishte kaluar gati një orë që ata rrinin shtrirë prapa një ledhi dhe prisnin. Ishin fshehur mirë prapa ferrave si dy gjarpërinj, ishin mbuluar me gjethe plepi dhe vështronin herë rrugën dhe herë detin. Tytat e pushkëve të tyre vështronin nga xhadeja, të gatshme të villnin zjarr, posa të dukeshin ata që prisnin.

— Do të na ketë gënjyer ai miku, o Rem agai, — pëshpëriti tjetri dhe lëvizi nga vendi se i ishin mpirë gjymtyrët.

— Rri aty dhe mos luaj vendit — ja ktheu tjetri i zemëruar nga ky dyshim i bashkëpunëtorit të tij dhe shtoi: — Se nuk na gënjen Sula, e njoh unë...

— E ku janë, pra? — vazhdoi Dulla të grindej me zë të ulët. — Jemi në mes të udhës dhe mund të kalojë njeri.

Rem agai heshti. E nga ta dinte ai se ku ishin ata, që donte të vriste me pushkën e tij të gjatë!

Ai dinte vetëm kaqë: ata të dy ishin armiqtë e tij dhe duheshin zhdukur. Pastaj, nga sytë këmbët dhe jashtë kufirit, se kjo tokë digjte si zjarri. Rem agai kishte vrarë mjaft njerëz gjatë viteve të luftës. Partizanë jo, se ata ta mbanin në lule të ballit, por Rema vriste fëmijë, pleq dhe u digjte shtëpitë. Këto punë nuk i bënte vetëm. Kishte shokë si veten atëhere. Pinin e bëheshin xurxull në shtëpitë e ballistëve dhe niseshin fushës si ujë të uritur. Megjithatë, armiqtë e Rem agait nuk ishin zhdukur ato vite të luftës; përkundrazi, ata shtoheshin nga dita në ditë dhe ahëre kur gjermanët ishin thyer, ata ishin bërë zotër të vendit. Ndërkaqë, miqtë e tij kishin mbaruar të gjithë. Ca ishin vrarë në çetat e ballit, ca ishin arratisur, të tjerët ishin fshehur ku kishin mundur dhe dridheshin si lepuri. Edhe Rema do të kishte shkuar me gjermanët, por i erdhi keq për pasurinë, që nuk donte ta linte në duar të partizanëve. Për atë pasuri Rem agai linte edhe kokën. Mirëpo punët çdo ditë venin keq e më keq për të dhe, me sa dukej, Rem agai do të humbiste edhe pasurinë edhe kokën.

Nga frika e partizanëve Rema u arratis në pyje së bashku me shokun e vet Dullën. Vetëm nganjëherë kthehej fshehura natën në shtëpi dhe ikte pa gdhirë.

Një ditë të diel në shtëpinë e tij kishin shkuar dy partizanë së bashku me disa fshatarë të varfër, që kishin qenë bujqërit e tij dhe i kishin marrë buajt, bagëtinë dhe bereqetin. Kur u kthye Rema në mbrëmje, i gjeti qilaret bosh dhe u bë si i çmendur. Dontë të rrëmbente pushkën dhe t'i vriste të gjithë ata, që i kishin marrë pasurinë. Po nuk ishin vetëm ata dy partizanë, që kishin vajtur në fshat.

Mbrapa tyre ishte e tërë brigada. Me brigadën partizane nuk mund të luftonte as Rema, as Dulla, as dhe ata dy-tre shokë, që i kishin mbetur dhe fshiheshin pyjeve. E kishin provuar gjatë luftës kur kishin edhe gjermanët me vete dhe ishin thyer e jo pastai!.. Kishin ardhur kohë të vështira për ta.

Të gjitha mund t'i duronte Rem agai, se fundja kjo kohë kishte ardhur, por kur i thanë se midis atyre që i kishin marrë bagëtinë kish qenë edhe një vajzë partizane, filloi të qeshte si i çmendur. S'kuptohej mirë në ishte e qeshur kjo, apo e qarë. Të të vijë një femër dhe të të hapë haurin e bagëtisë si në mall të babait e të mos jesh i zoti të bësh asgjë, këtë s'ja kishte marrë mendja kurrë dhe as që do t'ja merrte...

«Ah, kuçka, kuçka!» shante me zë të lartë dhe vinte rrotull si ndonjë bishë e plagosur. Sytë e dalë përjashta e gjithë damarë të kuq nxirnin lot zemërimi, dhe u betua se do t'i vriste ata të dy dhe do të zhdukej.

Mbas disa ditësh mori vesh se dy partizanët kishin shkuar nga fshati i tij në një tjetër, që ishte aty pranë. Rem agai nga strofka e vet i dërgoi haber një mikut të tij, që ta lajmëronte mbi lëvizjet e tyre dhe po priste. S'kaluan shumë ditë dhe miku u përgjigjej: Në akësh ditë ata të dy do të shkonin me motoçikletë në xhade, dhe Rema të bënte si t'i dukej më mirë.

Gjithë këto sillte ndër mend Rem agai, ndër- sa rrinte në pritë dhe vështronte me vëmendje xhadenë, që e kishte disa metra më tutje.

— S'po duken, o Remë!.. — u ankua përsëri Dulla dhe bëri të ngrihej. Gjethet që kishte hedhur mbi shpinë i ranë përtokë dhe ai i shtyri

me këmbë. — Ngrihemi, ikim, — vazhdoi ai — se po bëhet vonë dhe mund të kalojnë njerëz të tjerë në xhade.

— Shtriu aty, Dullë, dhe mos bëj llafe — iu kërcënua Rem agai shokut të vet. — Mos lëviz të them, se mund të na shohin.

Mirëpo Dulla s'dëgjonte. E kishte kapur frika për vdekje dhe çdo zhurmë e dyshimtë e tmerronte.

S'kaloi shumë kohë dhe diku larg u dëgjua zhurma e një motoçiklete. Fill pas saj te kthesa u dukën ata të dy, që po vinin drejt pritës me shpejtësi. Rema dhe Dulla u përplasën për tokë duke pëshpëritur:

— Erdhën!

— Erdhën! Erdhën! Sula s'na paska gënjer...

Kur kaluan ledhin me shpejtësi, u dëgjuan dy të shtëna pushke njëra pas tjetrës. Një flakë përcëllonjëse i shpoi krahun Teftës. Krismat e tjera të pushkëve nuk i dëgjoi. U var pas trupit të Nasit dhe, me të frenuar, motoçikleta u përplas në xhade.

Nasi rrëmbeu automatikun dhe zbrazti disa breshëri në drejtim të ledhit. Plumbat ngritën me vërshëllimë re të vogla prej pluhuri. Edhe një breshëri tjetër dhe atje prapa nuk lëvizi njeri. Ai kujtoi se i vrau dhe u ngrit pak të shikonte, por dy pushkë italiane u zbrazën menjëherë mbi kokën e tij.

Të dy palët ranë në heshtje. Tefta shkoi në një vend ku nuk e hante plumbi. Ai nuk kishte mundësi t'i vente në ndihmë, se do ta vrisnin porrsa të dilte nga pozicioni.

Ata të dy prisnin.

Ndërkaq, nga larg u dëgjua një bori automobili dhe zhurma e motorit të maqinës, që po afrohej nga ana e Durrësit. Të panjohurit filluan të zvarriteshin si gjarpërinj. Njëri prej tyre, trashalug dhe pak i shkuar nga mosha, nuk ishte fort i shkathët. Tek po ecte këmba-dorës, u ngrit paksa, por një breshëri automatiku e përplasi përtokë dhe bërtiti:

— o — o — o... Më vrau!

Kamioni po afrohej gjithnjë e më tepër. Tashmë dëgjohej jo vetëm uturima e motorit, por edhe përplasja e çrregullt e karrocërisë. Nuk ishte as treqind metra larg, kur ai tjetri matanë ledhit u ngrit, e la trashalugin e plagosur dhe filloi të vraponte me të katra.

— Ku shkon, o qen bir qeni, — mallëkoi Rem agai. — Si do të më lësh mua në dorë të partizanëve! Ndal! Ndal, se të vrava!..

— Ndal! — bërtiti edhe Nasi nga ana tjetër e xhadesë, por Dulla ishte i shkathët. Kapërxeu disa shkurre, që i dolën përpara dhe iku me vrap. Një çast dhe do të hidhej në përrua, kur breshëria e një automatiku e kositi në vend. Në fillim i ra pushka nga dora, pastaj u përplas edhe vetë në përrua me kokë poshtë.

Nasi doli nga pozicioni.

— Duart lart! — i tha atij, që rënkonte dhe s'levizte nga vendi.

Kur u afrua, e njohu kush ishte.

— Shih, shih kush na qenka! — tha duke e vështruar me urrejtje. — Rem agai, një «mik» i vjetër. Hë gjarpër! T'i shkurtuam duart tashti e s'ke për të kafshuar më...

Maqina, që mbërriti në atë kohë, frenoi me

zhurmë disa metra larg Teftës. Prej saj këcyen dy partizanë të rinj, i lidhën duart Rem agait dhe e përplasën si deng në karroceri të kamionit.

Nasi iu afrua Teftës. E ngriti dhe i hapi xhakaventon ku e kishte zënë plumbi. Nga krahu i rridhte një çurk gjaku. Vështroi Nasin dhe buzëqeshi.

— Ke dhimbje? — e pyeti Nasi dhe e ngriti duke e mbajtur me shumë kujdes. E uli në sedile të kamionit, kurse vetë u ul te timoni.

— Maqinën do ta ngas vetë — i tha shoferit dhe u nis për në spital.

MARKAT E ÇIMENTOS

— i —

Kishte kaluar gadi një vit që në Argjilas punohej për ndërtimin me forcat tona të një fabrike për prodhimin e çimentos. Argjilasi ishte një fshat, që shtrihej mbi ca toka argjiloze, të cilat i kishin dhënë edhe emrin. Fabrika ndërtohej aty, mbasi kishte pranë lëndën e parë: argjilën dhe gurin gëlqeror, që nevojitej për prodhimin e çimentos.

Një mëngjez gjithë diell, një korrespondent i ATSH-së me aparatën fotografik në sup zbriti nga një «ZIS», që e kishte sjellë gjer aty dhe hyri në oborrin e fabrikës së çimentos duke vështruar me kureshtje. Maqinat hynin dhe dilnin njëra pas tjetres në territorin e fabrikës. Shoferët, që kishin sjellë gurë gëlqerorë, argjilë dhe qymyr-guri, prisnin radhën për t'u shkarkuar.

— Po hë, more shok, hape rrugën të shkretën! . . .
— ankohej një shofer maqine vetëshkarkuese.

— Prit një herë, shoko, — ja ktheu gjakftohtë një tjetër. — Është me radhë këtu si në mulli. Ke qenë në mulli ndonjëherë? . . .

— Jo, s'kam qenë se më bluante plaku, po hape rrugën!

— Ku do të shkosh?

— Të shkarkoj. Nuk e sheh? Jam riportabël.

— Hajt, udha mbarë — tha shoferi tjetër dhe i hapi rrugën.

Korrespondentit të ATSH-së i kishin thënë se fabrika e re e çimentos kishte filluar të jepte prodhimin e parë dhe së shpejti do të inagurohej, prandaj ai vinte aty të mernte të dhëna lidhur me kapacitetin e fabrikës, me markën e çimentos dhe se si ish ndërtuar kjo fabrikë me forcat tona.

Pranë korpusit kryesor oxhaku i fabrikës tymoste rëndë-rëndë, kurse në gjithë teritorin e saj dëgjohej zhurma e mullinjve, që bluanin papushim.

— Bukuri! — tha korrespondenti me vete dhe u drejtua nga administrata. Në zyrën e drejtorit s'kishte njeri. Askush nuk u përgjegj as në dyert e tjera ku shkruhej «K-Mekaniku», «Kimisti», «Inxh. Teknologu», «Inxh. Elektriку». Administrata që e heshtur.

«Do të jenë në fabrikë» mendoi korrespondenti dhe u drejtua në repartet e prodhimit, ku shihej një ecë e jakë e shpejtuar e njerëzve, pluhur çimentoje dhe ku sundonte zhurma e madhe e mullinjve të çimentos.

Drejtorin e gjeti në një nga repartet e fabrikës, tek po shtynte një elektromotor së bashku me disa punëtorë. Ishte një burrë rreth tridhjetë e pesë vjet, me një trup mesatar, fytyrë eshtake me mollëza të dala. Flokët e drejtë i krihte përpjetë. Edhe ai kishte veshur kominoshe, ishte i djeritur dhe i lodhur. Megjithatë, ardhja e korrespondentit të ATSH-së e gëzoi dhe ai filloi të tregonte me qejf repartet e fabrikës.

— Kur të arrijmë të prodhojmë çimento nga kjo fabrikë, — tha ai me njëfarë krenarie, — do

të thyejmë një hallkë të blokadës imperialisto-revizioniste. Ju e kuptoni rëndësinë e kësaj vepre: pa çimento s'ka ndërtime, pa ndërtime s'ka socializëm.

— Po, e kuptoj, — thoshte duke tundur kokën korrespondenti.

— Fabrikat egzistuese nuk arrijnë të plotësojnë nevojat gjithnjë në rritje për çimento; prandaj ne duhet të sjellim një sasi nga jashtë. Po ju i dini vështirësitë që po na nxjerrin revizionistët në furnizime, për të penguar ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Kjo fabrikë u ndërtua krejtësisht me forcat tona. Maqineritë e saj u përgatitën në vend: një pjesë, nga disa ndërmarrje të Tiranës. Të tjerat u mblodhën sa andej këtej. Ja, p.sh., frontoja. E di cila është frontoja? Ajo, që thyen gurët. Ishte hedhur në një qoshe. Ne e morëm dhe e bëmë pajisje të fabrikës. Kështu, pra, çdo maqineri ka historinë e saj.

Korrespondenti e dëgjonte me vëmendje dhe diç shkruante në një blok. Herë pas here bënte ndonjë pyetje të shkurtër dhe përsëri shkruante. Tregimi i drejtorit po i pëlqente. Ai do ta përpunonte vetëm pak dhe lajmi ishte gati për agjensinë.

— Më vonë do të ngremë fabrika të tjera — vazhdoi drejtori të jepte sqarime, — një në Fushë-Krujë dhe një në Elbasan, dhe Shqipëria nga importuese e çimentos do të bëhet eksportuese e saj, por kjo fabrikë do të ketë rëndësinë e vet se u ndërtua krejtësisht me forcat tona.

— Me leje, shoku drejtor? — e ndërpreu një zë nga mbrapa.

Ata u kthyen. Ajo që i kishte ndalur ishte një vajzë e re, rreth të tetëmbëdhjetave, e veshur me

një përparëse të bardhë. Kishte dy sy të zez e të bukur që vështronin me ndrojtje, sikur të ishte ajo fajtores për ato që do të thoshte:

— Si është puna, Drita? — pyeti drejtori laboranten e fabrikës, duke e vështruar me vëmendje.

— Shoku drejtor! — tha ajo pa qejf. — Analizat nuk dolën mirë edhe kësaj here.

— Sa doli?

— Marka 150...

— Si t'ja bëjmë? NSHN,-të presin çimento; dita e inagurimit po afron, Zv.-ministri pret orë e çast që t'i njoftojmë markën e çimentos me telefon, e ne, ç'ti themi ne? Ja dhe korrespondenti i ATSH-së. Si t'ja bëjmë hallit? — fliste ai i humbur në mejtime.

Laborantja mblodhi supet me keqardhje dhe s'dinte ç'të thoshte.

— Është e pesta herë. — i tha ai korrespondentit të ATSH-së, që analizat japin të njëjtin rezultat. Mirëpo ne i kemi marrë të gjitha masat. Kësaj here duhej të kishte dalë të paktën çimento e markës 350 ose 400. Drejtori kërkoi inxhinierin teknolog dhe kryemekanikun.

Drita iku.

2

Lajmi mbi përfundimin e analizave u përhap menjëherë në fabrikë. Punëtorët lanë punën dhe u drejtuan në një nga repartet e prodhimit. Aty për aty do të bëhej një mbledhje e shkurtër e kolek-

tivit. Punëtorët diskutonin gjallërisht. Për të nxjerrë fabrika prodhimin e parë, ata kishin punuar natë e ditë, me orar dhe pa orar dhe rezultati... çimento e markës 150! Ku ishte gabimi? Mos kishte ndonjë të metë procesi teknologjik?

Besnik Dara s'dinte si t'u jepte përgjegje. Ai së bashku me sekretarin e organizatës bazë të partisë, Gramozin, rrinte në mes të tyre dhe po priste të vinin kryemekaniku dhe inxhinieri teknolog.

Kur erdhën kryemekaniku dhe inxhinieri teknolog, filloi menjëherë mbledhja e kolektivit.

Kryemekaniku ishte një djalë i ri rreth njëzet e tetë vjet, shtatlartë e simpatik, që e thërrisnin Maksi. Flokët i kishte të zez e të prerë shkurt, shpatullat të gjera e të fuqishme. Maksi kishte filluar të punonte si montator që katërmbëdhjetë vjet më parë, kur kishte mbaruar shkollën shtatëvjeçare, me një fjalë gjysmën e jetës së tij të re e kishte kaluar duke punuar nga njëra vepër industriale te tjetra. Besnik Dara e çmonte shumë këtë djalë të ri, të cilit ç'i shihte syri ja bënte dora. Maksi mund të punonte edhe si montator, si saldator, mekanik, hidraulik etj. Po të qe nevoja, bëhej shofer apo traktorist.

Sëbashku me Maksin erdhi në mbledhie edhe inxhinieri teknolog i fabrikës Bashkimi. Ishte një djalë njëzet e trevjeçar, i pakët nga trupi dhe tepër i ndrojtur. Atë vit kishte mbaruar për kimi industriale dhe kjo ishte prova e tij e parë në jetë. Vinte në mbledhje më i ndrojtur se zakonisht, sepse i dukej se ai mbante përgjegjësinë më të madhe për mosdaljen e markës së çimentos.

— Me leje, shoku drejtor, — tha një punëtor,

pasi filloi mbledhja, — deri më sot ne i kemi kërkuar të metat në procesin teknologjik. Po sikur ky të jetë në rregull dhe të mos jenë në rregull analizat?!

— Ka mundësi, — shtoi një tjetër. — Laborantet janë të reja dhe pa eksperiencë.

Drita, që rrinte më këmbë pak si mënjanë grumbullit, u trondit. Një purpur i lehtë i ra në fytyrë dhe, duke e ndjerë se të gjithë po shikonin atë, u skuq edhe më tepër.

— Jo, shokë, — tha ajo dhe zëri i dridhej nga emocioni. — Analizat janë fare në rregull. Ne i kemi bërë ato në prani të inxhinier Bashkimit.

— Atëhere kush e ka fajin?..

— Me lejë shoku drejtor? — tha inxhinier Bashkimi. — Unë mendoj se në këtë mes e ka fajin pikërisht procesi teknologjik dhe këtu përgjegjësinë e mbaj unë. Ne jemi në fazën fillestare të prodhimit, pra jemi akoma duke eksperimentuar. Nuk duhet të shqetësohemi për markën e çimentos. Ajo do të dalë patjetër 350 ose 400, ashtu sikurse e duam ne, por për këtë duhet të bëjmë ndryshimet përkatëse në përqindjen e gymyrit.

— Të them edhe unë dy fjalë? — ndërhyri Maksi duke buzëqeshur. — Përveç sa u tha më lart, unë mendoj se është e nevojshme të bëhet rikonstruksioni i furrës së pjekjes së klinkerit. Ajo akoma nuk e arrin temperaturën e nevojshme që kërkon procesi teknologjik i prodhimit të çimentos.

— Sa kohë ju duhet për këtë, Maksi? — pyeti Besnik Dara.

— Rreth dhjetë ditë, shoku drejtor.

Besnik Dara dhe sekretari i partisë u shikuan

sy më sy. Koha s'priste. Nevoja për çimento po bëhej nga dita në ditë më e ngutshme.

— A nuk mund të shkurtohet ky afat? — pyeti sekretari i partisë.

— Sigurisht që mund të shkurtohet. Varet se si do të punojmë. Ç'thoni ju, shokë? — pyeti ai duke u drejtuar nga montatorët.

— Të shkurtohet! — thanë ata njëzëri.

— Sa?

— Shtatë ditë.

— Pesë.

— Katër ditë, Maksi. Merr angazhim në emër të montatorëve.

— Mirë, pra, shokë, — tha Maksi duke iu drejtuar gjithë kolektivit. — Ne angazhohemi që të bëjmë rikonstrukcionin e furrës së pjekjes së klinkerit brenda katër ditëve. Do të punojmë me orar dhe pa orar për thyerjen e bllokadës imperia-
listo-revizioniste.

3.

Mbas disa ditësh në procesin teknologjik të fabrikës të çimentos u bënë ndryshimet përkatëse sipas rekomandimit të inxhinier Bashkimit. Furra e pjekjes së klinkerit u rikonstruktua plotësisht brenda 72 orëve pune pa ndërprerje. Ndryshoi gjithashtu përqindja e qymyrit në përbërjen e çimentos. Drejtori i fabrikës, i emocionuar, mori disa duar çimento dhe i tha një punëtori që e kishte pranë:

— Shpjere këtë çimento në laborator për të bërë analizat.

Mbasi mori çimenton të mbështjellë në një copë letër, ai ngjiti shkallët e hekurta të fabrikës për të vajtur në laborator.

Drita dhe inxhinier Bashkimi e morën çimenton e porsaprodhuar dhe po e vështronin me vëmendje, sikur të kishin përpara tokën e ndonjë planeti tjetër. Në dukje ajo s'kishte asnjë dallim nga çimentoja e jashtme dhe kjo gjë i kënaqi që të dy, por si do të dilnin analizat!.

— Ki kujdes, Drita, të lutem — i tha Bashkimi laborantes, kur ajo filloi nga puna.

— Mos ki gajle, inxhinier! — i tha ajo me ton të sigurt dhe shtoi: — Kësaj here do të dalë patjetër marka që kërkojmë.

— Ashtu qoftë! — tha ai dhe buzëqeshi me besim. Bashkimi futi duart në xhepet e bluzës së bardhë që kishte veshur dhe po vështronte nga dritarja. Para tij shtrihej një pamje e bukur, të cilën kishte qejf ta sodiste shpesh kur ndodhej në laborator; megjithatë, atë ditë nuk e kishte mendjen aty. «Po sikur të mos dalin analizat?!» mendoi i shqetësuar dhe iu kujtuan gjithë ato përpjekje që kishte bërë kolektivi i fabrikës së çimentos për të nxjerrë prodhimin e parë. «Nuk është e mundur» tha me vete, «kësaj here duhet të dalë të paktën marka 350. Ne i kemi respektuar të gjitha kërkesat e procesit teknologjik të pregatitjes së çimentos».

Disa ditë më vonë para derës së laboratorit ishin mbledhur një grup punëtorësh, që prisnin përfundimin e analizave. Midis tyre ndodheshin edhe drejtori i fabrikës, sekretari i partisë si dhe korrespondenti i ATSH-së. Pak më tutje Maksi, midis montatorëve të tij, bënte shaka dhe qeshte

me dikë që thoshte se marka e çimentos mund të mos dilte edhe kësaj here në rregull, sepse nuk ishte i përshtatshëm guri i gëlqeres!

Në korridor, ku prisnin ata, bënte vapë. Kjo shtohet edhe më tepër, sepse aty afër ishte furra e pjekjes së klinkerit, që qëndronte ditë e natë ndezur. Megjithatë askush nuk lëvizte nga vendi, sepse prisnin me padurim inxhinier Bashkimin të njoftonte përfundimin e analizave.

Së fundi doli inxhinier Bashkimi nga laboratori. Ai vetë ishte i emocionuar. Mbi ballë kishte plot bulëza djerse, kurse fytyra e tij dukej sikur kishte humbur çdo aftësi për të shprehur gjë tjetër veç hutimit.

— Po hë, more Bashkim, hape gojën! — i tha me shaka një punëtor nga fundi i grumbullit.

Mirëpo ai akoma nuk ishte në gjendje të fliste. Kështu i ndodhte gjithmonë kur dilte nga provimi në fakultet. Shokët, duke e parë të hutuar, kujtonin se nuk do të kishte dalë mirë në provim, megjithëse e dinin se ai ishte i shkëlqyer në mësim. Vetëm pasi i rrëmbenin librezën e notave nga dora dhe e shikonin vetë se si kishte dalë, i rrihnin shpatullat dhe e uronin.

Edhe kësaj here inxhinier Bashkimi kishte dalë nga provimi. Ky ishte ndoshta më i vështiri që kishte dhënë deri atëhere, prandaj vështronte i hutuar herë drejtorin, herë sekretarin e partisë dhe herë shokët, që ishin mbledhur pranë derës së laboratorit.

Prapa tij laborantja Drita, e veshur me bluzë të bardhë, qeshte e tëra dhe sytë e zezë i veçullonin nga gëzimi.

— Shokë! — tha ajo meqë inxhinier Bashkimi nuk po fliste. — Çimentoja jonë doli e markës 400. Urra!

— Urra! — u përgjegjën njëzëri të gjithë ata që ishin mbledhur pranë laboratorit dhe filluan të uronin njëri-tjetrin. Dikush përqafonte shokun që kishte pranë dhe pastaj i binte me grushte mbi supe për të shprehur gëzimin, një tjetër e hodhi lart në tavan kapelën. Vetëm Drita, që ishte e vetëmja vajzë, rrinte pak si mënjanë dhe derdhte lotë gëzimi.

Ndërsa shokët e shprehnin gëzimin në një mijë mënyra, drejtori u tërhoq te ballkoni dhe vështronte fabrikën nga lart si një prind që kundron krijesën e vet.

— Vështro — i tha ai korrespondentit të ATSH-së — se sa e bukur duket fabrika jonë që këtej; sa mund e djersë na është dashur për të arritur deri këtu!... Dhe ja së fundi fitorja. Kishte të drejtë Zëvendësministri kur më tha se nuk ka kala që nuk e marrin komunistët. Ti nuk mund ta marrësh me mend se sa të gëzuar jemi sot ne ndërtonjësit e fabrikës dhe duam që këtë gëzim ta ndajmë me të gjithë shokët tanë...

Korrespondenti i ATSH-së e dëgjonte me kënaqësi dhe buzëqeshte; mandej ai u nis për në zyrë që të njoftonte këtë lajm me rëndësi.

Të nesërmen në mëngjez tri «Skoda» të ngarkuara plot e përplot me çimento dolën nga oborri i fabrikës. Boritë e tyre, që dëgjoheshin qartë në ajrin e pastër të atij mëngjezi gjithë diell, dukej sikur thoshin: «E thyem blokadën, e thyem, e thyem!...»

G J Y K A T Ë S I

1.

— Do të qëndroni gjatë në qytetin tonë? — e pyeti shoferi udhëtarin e vet.

Tjetri nuk u përgjegj menjëherë. Ishte një djalë i ri, jo më tepër se njëzet e pesë vjet, shtatë-lartë dhe tepër serioz. Dukej se nuk kishte qenë tjetër herë në këto anë, sepse vazhdimisht vështronte nga dritarja e maqinës dhe pyeste si quhej ky apo ai vend.

— Tashi porsa jam emëruar në këtë qytet — u përgjegj pas pak.

— Me ç'detyrë?

— Gjykatës.

— Oh, shumë mirë — u përgjegj shoferi duke buzëqeshur. — Ai shoku që ishte para jush doli në pension.

— E di.

— Detyrë e vështirë, apo jo?.. — tha shoferi duke vështruar rrugën, — sidomos për ju që jeni kaq i ri në moshë.

— Ashtu është vërtet — pranoi gjykatësi mendueshëm.

— Në gjykatë keni një kolektiv të mrekullueshëm. Kryetari — shpirt njeriu, edhe të tjerët

gjithashtu. I njoh unë se jam shofer i komitetit ekzekutiv.

Tomori e dëgjonte dhe mundohej të përfytyronte shokët e tij të punës. Vërtet, si do të ishin ata?..

Para tij parakalonin gurë kilometrazhi të lyer me gëlere të bardhë, shtylla telefoni me një tufë telash paralele, që zgjateshin pa kufi; një pejsazh i tërë malor shtrihej në krahun e djathtë të rrugës. Ai vështronte parcelat me grurë, që verdhonin poshtë nën shpatin malor, mbi të cilin gjarpëronte rruga automobilistike, shtyllat e tensionit të lartë, një tufë zogjsh, që gatiteshin për fluturim mbi telat e telefonit dhe mendja i shkonte herë në të shkuarën dhe herë në të ardhmen.

«Sa shpejt kaluan katër vjet!» — tha me vete i habitur dhe iu kujtua ajo ditë shtatori kur mbërriti në Tiranë për të vazhduar studimet në Fakultetin e shkencave politike dhe juridike.

...Ishte një ditë me diell. Ai zbriti nga treni me një valixhe të rëndë prej druri në dorë dhe u nis pas vargut të gjatë të udhëtarëve, që dilnin nga stacioni. S'kishte qenë ndonjëherë tjetër në Tiranë, prandaj i bëri përshtypje ajo mori njerëzish, që zbritën nga treni dhe morën rrugën për në qendër të kryeqytetit. Kur doli në bulevardin «Stalin», e la për një çast valixhen përtokë dhe vështroi përreth me kureshtje. Llambat me neon, të përkulura me hijeshi në të gjithë gjatësinë e bulevardit, pallatet shumëkatëshe në të dy anët e tij, si dhe ndërtesa e bardhë si mjelmë e universitetit e lanë pa mend. Pasi pyeti disa kalamaj, mori rrugën drejt shtëpisë së studentit, duke buzëqeshur me vete.

Dhe ja tani, pas katër vjetësh, me fletën e emërimit në xhep, ai nisej në krye të detyrës në këtë qytet të largët të Shqipërisë.

«Por a do të jem në gjendje ta kryej detyrën si duhet?.. » tha përsëri me vete dhe vështroi një tufë zogjsh, që fluturonin gjithë qejf në atë qiell të kaltër.

— Kemi edhe shumë rrugë për të bërë? pyeti ai shoferin.

— Jo, dhe pak e mbrimë, shoku Tomor.

Me të vërtetë, pas disa kilometrash, kur dolën në një qafë mali, u duk qyteti si në pëllëmbë të dorës. Shtëpitë e vogla dhe të radhitura me rregull midis gjelbërimit i pëlqyen Tomorrit.

Në atë qytet të vogël gjetën menjëherë shtëpinë, ku do të banonte.

Ishte një shtëpi dykatëshe ngjyrë rozë, ndër-tuar ndanë një rrugice të shtruar me kalldrëm. Mbi avllitë e larta, që e rrethonin, vareshin degë pemësh dhe hardhish. Nga dera gjysmë e hapur Tomori pa një oborr të pastër të shtruar me plloça, që porsa ishin larë, si dhe lule gjithfarësh.

E zonja e shtëpisë, teto Vita, një grua bojallëshë, flokëthinjur dhe e dashur si një nënë, i tha se dhoma e tij ishte ajo e katit të parë. Mandej e ndihmoi të shpinte plaçkat dhe, kur hynë brenda, e pyeti me dashamirësi:

— Po si je, mo bir, si i ke nga shtëpia?

— Mirë të falemnderit.

— Nga të kemi?

— Nga Berati.

— Që andej vjen?

— Që andej, teto.

— Po u lodhe shumë? Rrugë e gjatë e shkreta!

— Jo, teto, s'jam lodhur dhe aqë.

— Ja, kjo është dhoma jote — tha ajo duke i treguar dhomën ku do të jetonte. — Nuk është shumë e madhe, por është me dritë dhe me diell. Para teje rrinte një inxhinier i ri si dhe ti. Djalë i mirë si një nuse. S'ka as një muaj që ka ikur këtej se e transferuan pranë familjes. Mua më erdhi keq se e desha si djalin tim. Por ç'po flas kështu! Ti ndoshta je lodhur nga rruga, biri im, dhe rri e më dëgjon mua plakën.

— Jo, teto, ç'është ajo fjalë! — tha Tomori duke buzëqeshur.

— Mirë, bir, mirë. — Dhe plaka iku.

Si mbeti vetëm, ai i hodhi një sy dhomës së vet. I pëlqeu që dritarja e vetme e saj binte në lulishtë. Që andej dukeshin disa rrënjë mollësh dhe dardhash si dhe lule që rriteshin me kujdes prej zonjës së shtëpisë. Lule kishte ngado. Edhe në hekurat e dritares së tij harliseshin gjithë ato lule dredhëzash, që kishin çelur gonxhe ngjyrë manushaqe. Atë mbasdite Tomori u mundua ta rregullonte disi dhomën.

2.

Ky qytet ishte qendra e një rrethi të vogël në jug të Shqipërisë; i vogël dhe i pastër, i ndërtuar mbi një fushë që rrethohej nga male të zhveshura e shkëmbore. Mes për mes përshkohej nga një she-titore e gjerë, e drejtë dhe e asfaltuar. Në të dy anët e rrugës ngriheshin gati të gjitha ndërtesat

kryesore të qytetit, si komiteti i partisë, komiteti ekzekutiv, shkolla 11-vjeçare, MA-PO industriale etj. . . Të gjitha të reja e të bukura, të ndërhuara rishtazi e të lyera me kujdes. Mbrapa tyre shtriheshin lagjet e vogla të qytetit. Më tej zona industriale dhe një fushë pjellore, ku çante mes përmes rruga automobilistike.

Godina e gjykatës popullore s'kishte as dy vjet që ishte ndërtuar. E lyer nga jashtë me ngjyrë blu, ajo dukej nga larg si e thelluar në mendime. Vijat e drejta e të bardha të dritareve vinin në kontrast me ngjyrën e përgjithshme, thyenin monotoninë dhe i jepnin godinës hijeshi. Ndërtuesi ishte treguar praktik dhe i kujdesshëm kur kishte projektuar në oborrin e saj një lulishte. Duke kaluar nëpërmes saj, Tomori pa disa fshatarë të ulur në stola, që prisnin fillimin e gjykimit.

Një grua e re po ecte e shqetësuar në korridorin e gjykatës, duke mbajtur për dore një fëmijë trevjeçar.

— Po ç'është kështu — e pyeti ajo pastruesen e gjykatës, — përse nuk po fillon gjyqi ynë, akoma duhet të presim?

— Prisni pak — iu përgjegj ajo, — se kanë shumë punë. Kryetari ka mbetur vetëm dhe nuk ja del dot. Po pret nga dita në ditë të vijë një gjykatës i ri në vendin e të vjetrit, por, me sa duket, ai s'ka ndër mend të vijë.

Tomorit i erdhi për të qeshur nga fjalët e saj. Donte t'i thoshte: «Nuk e shikon gjykatësin e ri? E ke përpara syve», por iu kthye mendja dhe e pyeti në ishte kryetari në zyrë.

— Është, posi — u përgjegj shpejt e shpejt

pastruesja, — por nuk ka pritje tashti. Eja në orën dymbëdhjetë.

— Ashtu, në orën dymbëdhjetë the?.. Eh po mua mbase do të më presë para kësaj ore. — po bënte shaka Tomori.

— Para kësaj ore kryetari s'pret as babën e vet, sepse do të dalë në seancë gjyqësore, por hapu, djalë i mbarë, se mos pluhurosesh.

— Atëhere shko i thua se ka ardhur gjykatësi i ri.

— Ka ardhur? — pyeti ajo dhe e la fshesën mënjane. — Po ku është?

— Ja, pra, unë jam..

Kryetari i gjykatës popullore, Vasil Lera, ishte një burrë i thyer nga mosha, i hequr në fytyrë, me një hundë pakëz të madhe, që i jepte fytyrës së tij një pamje disi të vrejtur, por, për çudi, ai kish-te dy sy të pastër e të kaltër që vështronin me dashuri. Tomori vuri re gezimin e papërmbajtur të këtij burri të shkaktuar, sigurisht, nga mbërritja e tij, por, në këtë vështrim ai vuri re edhe një farë mosbesimi të shkaktuar mbase nga mosha e kolegut të ri. Kështu i dukej Tomorit, që tashti vinte re gjithshka, por, sidoqoftë, iu bë qejfi nga hareja, që shkaktoi në gjykatë ardhja e tij dhe kjo sikur ja ngrohu zemrën.

— Anife, — i tha kryetari pastrueses, — shko e na thirrë shokët e punës që t'i njohim me Tomorin ose jo, — ndërroi mendje aty për aty, — prit një herë të bisedoj unë me të pastaj le të njihet me të gjithë.

Biseda me kryetarin e gjykatës nuk zgjati tepër. Tomori u njoh aty me problemet e rrethit në përgjithësi, me volumin e punës në gjykatë, etj.

Mandej kryetari i dha një tok me këshilla, që kishin të bënin me karakterin delikat të punës në gjykatë. Së fundi Tomori u njoh me gjithë personelin e gjykatës.

3.

Në derën e zyrës u ndje një e trokitur e lehtë. Tomori ngriti kokën dhe pa sekretaren që po hynte me një dosje në dorë.

— Shoku Tomor, — tha ajo duke buzëqeshur — kryetari e ka caktuar këtë çështje për ju. Do të filloni të gjykoni.

— Ju falem nderit! — tha ai dhe e mori me kujdes atë dosje të mbështjellë me kapakë të bardhë, ku nuk ishte tharë akoma boja e shënimeve që kishte bërë kryesekretari.

Tomori hapi kapakun e dosjes që do të gjykonte dhe lexoi emrat e të pandehurve; mandej lexoi me një frymë aktakuzën. Ngjarja ishte e thjeshtë dhe dramatike: shkesi, i fejuari dhe një vajzë, viktimë e zakoneve prapanike. Sa e sa çështje të tilla ishin gjykuar kohët e fundit në mbarë Shqipërinë!..

Gjithë atë ditë e studjoi me vëmendje atë dosje, e lexoi me imtësi, nxori shënime. Të pandehurit ishin munduar t'i shmangeshin përgjegjësisë penale, por midis thënjeve të tyre kishte kontradikta. Tomori i konspektoi me kujdes dhe i nënvizoi kundërthënjet me qëllim që t'i sqaronte gjatë gjyqimit. Mandej i hapi edhe një herë librat që por-

sa i kishte mbyllur në fakultet. Studjoi me vëmendje pjesët që kishin lidhje me çështjen që do të gjykonte dhe, pasi mbaroi këtë punë, zuri të mendohej. . .

Para tij kishte një dramë të vërtetë për të gjykuar, plot me konflikte të mprehta, me personazhe pozitive dhe negative. Secili kishte vepruar në jetë i shtyrë nga botëkuptimi i vet deri sa çështja kish mbëritur në gjyq.

Në dosjen penale bëhej fjalë kalimthi edhe për një njeri, që nuk ishte thirrur fare në gjyq, por që, me sa dukej, kishte luajtur një rol pozitiv në këtë çështje. Ky ishte një djalosh shtatshkurtër, i veshur me një xhaketë ushtarake dhe me një palë pantallona doku bojë qielli, që punonte si traktorist në fermë. Diku në një faqe të dosjes penale njëri nga të pandehurit kishte thënë se e kishte parë këtë djalosh një ditë prilli me shi tek përcillte Fatimen në rrugën e madhe të fshatit, që të shpie në qytet. Nga të dhënat e dosjes penale dilte se po atë ditë Fatimja kishte shkuar me të vërtetë në qytet dhe kishte trokitur për ndihmë në derën e komitetit të rinisë. Atëhere kush ishte ky djalosh dhe çfarë roli kishte luajtur në këtë çështje? . .

«Tashi për tashi mund të themi vetëm kaqë — tha Tomori me vete, — që ky djalosh, kushdo qoftë, ka luajtur me siguri një rol pozitiv në çështjen e Fatimes».

Të nesërmen bisedoi me sekretarin e organizatës bazë të partisë në fshat lidhur me organizimin e gjyqit.

Pertef Lllulla ishte një burrë jo më tepër se dyzet vjet, shtatshkurtër dhe pak i dobët. Kishte veshur një kostum doku ngjyrë gri, që i rrinte pak i gjerë për trupin e tij.

— Ju jeni gjykatësi i ri? — pyeti ai duke buzëqeshur çiltër.

— Urdhëroni! — i tha Tomori dhe i dha dorën.

— Unë jam Pertef Llulla, sekretar i organizatës së partisë — u paraqit tjetri thjesht.

Mbrapa tij vinte një vajzë e re rreth të tetëmbëdhjetave, serioze dhe simpatike. Kishte veshur një fund prej doku ngjyrë bezhë dhe një bluzë pupline borë të bardhë. Flokët e dendur e ngjyrë gështenjë i kishte krehur thjeshtë. Në qëndrimin e saj të matur, në veshjen e rregullt dhe në vështrimin e sigurtë kishte diçka të bukur, që të tërhiqte vëmendjen menjëherë.

«Kush do të jetë kjo vajzë?» — tha Tomori me vete dhe vështroi nga Pertefi, sikur kërkonte shpjegime.

Sekretari i partisë ja kuptoi mendimin dhe e paraqiti menjëherë:

— Ilirjana është arësimitare në fshatin tonë dhe sekretare e organizatës së rinisë.

Tomori i dha dorën dhe i ftoi të uleshin në karrigë.

— Uluni ju lutem — tha ai duke buzëqeshur. — Unë ju kam pritur gjithë ditën.

— Do të kishim ardhur me kohë — sqaroi Pertefi, — por mbetëm në një mbledhje në Komitetin e partisë lidhur me fushatën e korrjeve. Meqë edhe Ilirjana kishte punë në seksionin e arësimit, vendosëm të vinim së bashku.

— Shumë mirë keni bërë — tha Tomori. — Unë desha të bisedonim një herë së bashku për organizimin e gjyqit dhe për disa çështje të tjera.

— Eh, more shoku Tomor, — e ndërpreu Pertefi, — këto gjëra nuk duhej të ndodhnin në fshatin tonë, por ja që ndodhën... Ne vetë nuk duhej ta kishim lënë punën gjer aty.

— Mirë do të ishte që çështjet të parandaloheshin, — tha Tomori, — por sidoqoftë kjo ndodhi. Tashi të hyjmë në temë. Çështja është me rëndësi. Persona si shkesi apo si i fejuari i Fatimes nuk janë vetëm fanatikë. Të shtyrë nga zakonet prapanike të së kaluarës, ata kanë kryer veprime të kundërligjshme. Për këtë arsye kundër tyre nuk mund të përdoret më rruga e bindjes. Sidoqoftë, ata nuk janë të vetmit njerëz me mendime prapanike; duhet të ketë edhe të tjerë. Për të zhvilluar një luftë sa më efektive kundër zakoneve prapanike, unë mendoj që gjyqin ta zhvillojmë në fshat, në qoftë se jeni dakord edhe ju.

— Shumë mirë e keni menduar — e aprovoi mendimin e tij Ilirjana dha pastaj shtoi duke u skuqur lehtazi në fytyrë: — Ky do të jetë një dush i mirë për fanatikët.

— Ju, shoku Pertef, si mendoni? — pyeti Tomori.

— Në një mendje me ju jam edhe unë, shoku Tomor, — tha ai, — bile ne, para se të vinim këtu, kishin ndër mend edhe vetë t'jau kërkonim zhvillimin e gjyqit në fshat.

— Kohët e fundit gjyqe të tilla janë zhvilluar edhe në rrethe të tjera të Shqipërisë — shtoi Tomori. — Tashi të shohim së bashku cilët janë të pandehurit. Le t'i marrim me radhë. Kush është ky Nazmi Haxhiu?

— Shkesi... — tha Ilirjana duke vështruar nga Pertefi.

— Kemi të bëjmë me një shkes profesionist — sqaroi sekretari i partisë, — që gjithë jetën është marrë me punë të tilla.

— Shiq po shoh — tha Tomori, ai ka shfrytëzuar mirë lidhjet shoqërore dhe familjare me këtë apo atë person.

— Po — tha Pertefi. — Këtu fejonte një vajzë me një plak, atje një tjetër me ndonjë sakat apo me ndonjë që i kishte vdekur gruaja, dhe në fshatrat tona ishte hapur fjala se po e filloi një krushqi Nazni Haxhiu s'e linte pa mbaruar.

— Njëherë — shtoi Ilirjana, — unë kisha marrë vesh se ai po lidhte një krushqi të tillë. Vajza ishte ende e mitur, nxënëse në klasën e shtatë të shkollës sonë. E ruajta një ditë tek po shkonte në arë për të punuar dhe i fola për këto punë të papëlqyera që po bënte në fshat, po ai ma preu shkurt: «Ti shiko punët e tua dhe mos u merr me hallet e botës, se do të mplakesh shpejt» .

— Po — tha Tomori — me të do të kemi punë.

4.

Ditën e gjykimit të çështjes Tomori, së bashku me prokuroren dhe me sekretaren e tij të seancës, hypi në «Gazin» e prokurorisë që e priste te dera dhe u nis. I mbështetur në sedilen e maqinës, ai vështronte rrugën që çante mes për mes fushës plot me duaj gruri të porsakorrur. Aty-këtu kishte akoma togje kashte të pambledhur, ashtu siç i kish-te lënë autokombajna. Prej andej vinte një aromë

e shëndetshme dhe e këndshme e përzjerë me ajrin e freskët e atij mëngjezi. Mbi barin e mezhdave, mbi kallëzat e grurit dhe mbi togjet e kashtës kishte pikuar vesa e mëngjezit. Fshatarët kooperativistë e kishin filluar punën herët. Tek shihnin këtë maqinë që çante mes për mes fushës me shpejtësi, duke ngritur nga prapa një re të dendur pluhuri, ata ngrinin kokën dhe vinin njërën dorë mbi sy për të mos i vrarë drita e diellit.

Tomorit i pëlqente ai ambient fshatarak, ato pisha të gjata e majëmprehta, që i shihte anës së rrugës, ato parcela të gjera, ku tundej gruri si flori dhe nuk ngopej së vështruari. Megjithatë, mendja nuk i hiqej nga gjyqi i parë në jetën e tij që do të zhvillonte pas disa orësh. Tek vështronte atë pejsazh fsharak përtej dritareve të maqinës. thellë në veten e tij i riprodhoheshin skena të ndryshme të ngjarjes që do të gjykonte së shpejti.

Së fundi arritën në fshat nga një rrugë e pa-asfaltuar që dredhonte vazhdimisht.

Në sheshin pranë zyrave të kooperativës ishin mbledhur gjithë ata njerëz, të cilët kishin ardhur nga fshatrat rreth e rrotull. Ata rrinin grupe-grupe në oborrin e kooperativës dhe bisedonin. Midis tyre Tomori takoi Pertefin dhe kryetarin e kooperativës. Pak më tej ishte Ilirjana me disa vajza fshatare. Ajo, si e njohur e Tomorit, u nda prej tyre dhe i dha dorën, duke buzëqeshur me ndrojtje.

— Besoj i keni bërë të gjitha përgatitjet — i tha Tomori.

— Siç e shikoni, gjithshka është gati.

— Fatimja ka ardhur? — pyeti ai.

— Ka ardhur.

— Cila është?

— Ajo që ka veshur një fustan basme bojë qielli. Mos doni ta thërres?

— Jo, të falem nderit. Tashi për tashi nuk është nevoja.

Gjyqi do të zhvillohej në një pemishte, aty pranë. Midis degëve të mollëve ishte vendosur një tavolinë për trupin gjykues e mbuluar me beze të kuqe dhe një për prokuroren. Populli do të ulej përtokë, se nuk mjaftonin stolat. Për të dëgjuar më mirë zhvillimin e gjykimit, në të katër anët ishin vendosur altoparlantë.

Këtu s'kishte shumë ceremoni. Gjithshka zhvillohej thjesht dhe pa formalitete. Tek zinte vend në tavolinë së bashku me ndihmësgjyqtarët, Tomorit iu kujtuan padashur leksionet e historisë së institucioneve politike dhe juridike. Sa e sa formalitete, ceremonira të kota e pompoze kishin përdorur gjykatësit gjatë shekujve! Toga të zeza, paruka, simbole, betime, formalitete!.. E ç'ishin gjithë këto rekuizita për në muze para atij gjyqi të thjeshtë të popullit që zhvillohej jashtë në fushë! Këtu kishte ndofta vetëm një simbol: ajo copë e thjeshtë dhe e kuqe mbi tavolinë. . .

— I pandehuri Nazmi Haxhiu! — tha Tomori, kur filloi gjykimi, dhe vështroi ata të dy që rrinin ulur mbi një stol përballë prokurores.

— Këtu.

U ngrit një burrë shtatshkurtër, mbi pesëdhjetë vjet, i veshur me një xhaketë kadifeje tepër të përdorur.

«Ky qenkërka shkesi!» — mendoi Tomori me vete dhe vazhdoi:

— I pandehuri Xhelal Idrizi!

Dhëndri ishte gati në një moshë me shkesin. Njëlloj si ai, ishte i rrudhur në fytyrë dhe i thinjur nga flokët, por vinte më thatim dhe kishte një vështrim të turbullt dhe të frikshëm.

— Këtu jam — tha, duke vështruar herë trupin gjykues dhe herë bahçen e mbuzhur plot me njerëz. Në fytyrat e tyre, që i shihte si nëpër mjegull, ai dallonte mirë një buzëqeshje tallëse, prandaj ndrydhej e strukej prapa kurrizit të shkesit për të mos rënë në sy.

* * *

... Ndërsa prokurorja lexonte aktakuzën dhe demaskonte të pandehurit, duke cituar pjesë nga fjalimi i 6 shkurtit, Fatimja priste diku nga fundi i bahçes, e mbështetur pas një peme. Ishte një vajzë e re rreth të shtatëmbëdhjetave, me dy sy të zez të trembur nga ngjarjet që po zhvilloheshin. Faqet e saj, që dikur kishin qenë të kuqe e plot shëndet, tani kishin nxjerrë në dukje një zbehje të lehtë. Ilirjana dhe disa shoqe të tjera, që i rrinin pranë, diç i thoshin. Ndofta i jepnin kurajë për të demaskuar të pandehurit dhe zakonet prapanike, por ajo nuk e kishte mëndjen aty.

«Si do të flas atje?» pyeste veten herë pas here e shqetësuar dhe vështronte gjithë ata njerëz, që ishin ulur këmbëkryq dhe dëgjonin.

Kur ardhni radha e saj për të folur, sekretarja e seancës iu afrua mikrofonit dhe thirri:

— Fatime Isufi! Fatime Isufi!

— Fatime Isufi! Fatime Isufi! — përsëritën

altoparlantët e vendosur mbi degët e pemëve nga të katër anët.

«Si do të flas atje?» përsëriti sërishmi me vetëvete dhe vështroi përmbi kokët e bashkëfshatarëve, që prisnin t'i afrohej gjykatës.

Sekretari i partisë, që ishte aty pranë, iu afrua nga prapa dhe i tha:

— Shko, Fatime, dhe mos ki frikë. Të gjithë janë me ty...

«Vërtet — tha ajo me vete — të gjithë janë me mua. Ja edhe ata dy ndihmësgjyqtarët janë nga anët tona. E përse të kem frikë?! Me mua është partia, është i gjithë populli...»

Dhe u afrua para gjykatës me ngadalë, duke luajtur me shaminë që kishte mbështjellë pas qafës. Në fytyrë i rrëshqiti një nur i kuq sikur ishte ajo faktore dhe jo ata të dy që gjykoreshin atë ditë.

— Emri juaj? — pyeti Tomori, duke e vështruar me dashamirësi.

— Fatime Isufi.

— Emri i babës?

— Shaban.

— Datëlindja?

— 1950.

— Ç'lidhje keni me të pandehurit?

— Njeri prej tyre ka qenë i fejuari im, tjetri shkese i tij...

— Ç'dini të na thoni rreth çështjes?

Ajo i dinte të gjitha. E kush do t'i dinte më mirë se ajo!.. Por sa të vështirë e kishte të fliste para të gjithë atyre njerëzve! Mendimet po i ngatërroheshin dhe s'dinte nga të fillonte më parë. Megjithatë, qëndrimi dashamirës i trupit gjykues, i prokurores dhe i gjithë njerëzve, që e vështro-

nin me kërshëri, i dha zemër dhe filloi të fliste lirisht. . .

— Një ditë vjeshte, shtatë vjet më parë, më thanë se isha fejuar me këtë plak. Atë ditë në shtëpinë tonë kishin ardhur shumë miq. Nëna dhe motrat e mia më të mëdha shpinin kafe në dhomën e miqve dhe ktheheshin me filxhanet bosh. Nuk e di sepse më mbetën sytë te filxhanet e kafesë. Kisha dëgjuar se tek ato figura të çuditshme lexohej fati i njeriut. Ndaj isha kureshtarë të dija se si qenkësh ky fati im!.. Në atë çast sytë m'u mbushën me lot dhe dola përjashta në oborr. Shtëpia jonë është ndërtuar atje lart mbi një kodër shkëmbore. U ula mbi një gur pranë një gorice dhe fillova të mendoja për jetën time si ndonjë e madhe.

Nuk e di sa ndenja atje si e ngurosur. Në shtëpi u ktheva pasi shkuan miqtë dhe fillova të qaja. Megjithëse isha vetëm dhjetë vjet, prapë kuptoja shumë gjëra. . .

Porsa filloi Fatimja të fliste, në sheshin ku zhvillohej gjyqi u bë menjëherë qetësi. Njërëzit që kishin ardhur për të dëgjuar, lanë menjëherë çdo bisedë dhe po dëgjonin me vëmendje. Mbi sheshin e gjerë të kooperativës deri te shtëpitë e fshatarëve, që ishin ndërtuar larg njëra-tjetrës, dëgjohej zëri i përforcuar prej altoparlantit, bile edhe frymëmarrja e shpejtë dhe gjithë emocion. Kjo vajzë e qetë dhe e thjeshtë, që fliste rrallë, kësaj here demaskonte dhe demaskonte vazhdimisht.

— Kështu kaloi fëmijëria ime — vazhdoi Fatimja. — Jeta ime nga ajo ditë ishte si një ankth, një pritje e gjatë për ditë të këqia. Prandaj kur dëgjova të flitej për fjalimin e 6 shkurtit, kur mora vesh se do të prisheshin fejesat e lidhura sipas za-

koneve prapanike, zemra më rrahu fort. Po lindnin ditë të reja edhe për ne.

Në fshatrat pranë nesh po bëheshin kuvende të popullit; prisheshin fejesat në djep, flakeshin zakonet prapanike; të rinjtë dilnin vullnetarë për në hekurudhë.



Një kuvend i tillë i madh do të bëhej edhe në fshatin tonë.

Dy ditë para se të mblidhej populli, fola me babën për punën e fejesës sime. Për çudi ai më dëgjoji deri në fund. J'u luta me lot në sy që të prishte fejesën time e të mos ma nxinte jetën. Ai vetë nuk fliste asnjë fjalë, vetëm dëgjonte në he-

shtje dhe mendohej vazhdimisht. Unë e dija që ai nuk ishte më i pari, por lëkundej. Në kuvend, kur pa se edhe të tjerët po i prishnin fejesat e lidhura sipas zakoneve të vjetra, u ngrit edhe ai. «Tashti shpëtova» thashë me vete «dhe s'do të ketë forcë në botë të më çojë tek ai plak» që e ureja me gjithë shpirt.

Po atë mbrëmje që babai dha fjalën në kuvend se e prishte fejesën time, shkesi dhe i fejuari trokitën në derën e shtëpisë sonë. Unë i ndjeva nga hapat, i njoha nga zëri dhe u drodha. Nga dhoma e zjarrit dëgjova se si babai i çoi te dhoma e miqve. Tashmë unë kisha vendosur të luftoja edhe vetë për jetën time. Ashtu në errësirë, unë munda të përgjoja diçka.

«Qënkërke bërë komunist i flaktë» — i tha shkesi babait.

«Ashtu duhet» — ja ktheu ai i vendosur.

«Mos do të prishësh zakonet tona?»

«Ato që janë për të prishur, le të prishen...»

«Kështu thua ti?»

«Kështu thotë partia».

«Që kur ti, Shaban Isufi? Sa paskërke ndryshuar! Ta kishim ditur më parë, nuk do të kishim bërë krushqi së bashku...»

«S'prish ndonjë punë. Edhe tashti nuk është vonë. Siç e keni marrë vesh, krushqinë e kemi prishur».

«Po fjala e dhënë!»

«Fjalën duhet ta japë Fatimja e jo unë...»

«Sipas zakoneve tona, vajzat nuk pyeten».

«Tashti kemi zakone të reja».

«Kush prish të vjetrat e paguan me kokë...»

«Dëgjo këtu ti, shkes i keq, — i tha babai dhe e kapi për xhakete me forcë — këtu jemi në shtëpinë time dhe nuk lejoj njeri as të më shajë dhe as të më kërcënojë, prandaj dilni përjashta! Midis nesh ka mbaruar çdo gjë...»

Ata të dy dolën të zemëruar dhe u zhdukën në errësirë.

— I pandehur Nazmi Haxhiu, — pyeti Tomori — na shpjegoni pse vendosët rrëmbimin e Fatimes.

Shkesi u ngrit menjëherë në këmbë. Si ndonjë bishë e kapur në lak, ai vështroi i trëmbur sa andej këtej dhe filloi të jepte shpjegime me vështirësi:

— Kishim dëgjuar se ajo së shpejti do të shkonte në hekurudhë, shoku kryetar...

— Pastaj?..

— Atje mund t'i kthehej mendja lidhur me fejesën me Xhelalin.

— Pse, kishte qënë ndonjëherë dakord ajo lidhur me këtë fejesë?

— Fejesa ishte lidhur kur ajo ishte akoma fëmijë. Mandej ne nuk e kemi zakon të marrim pëlqimin e vajzave në raste të tilla.

— Po kur u rrit ajo, ç'mendim kishte për këtë fejesë?

— Nuk ishte dakord. Ne këtë e dinim, por nuk na prishte ndonjë punë.

— Si kështu?..

— Përderisa kishim pëlqimin e të atit, gjithshka ishte në rregull, por më vonë, pas fjalimit të 6 shkurtit...

— Ç'ndodhi pas fjalimit të 6 shkurtit?..

— I ati e dha fjalën në kuvendin e fshatit se

e prishte këtë fejesë të lidhur sipas zakonit të vjetër. Ne këtë nuk e prisnim dhe u shqetësuam shumë.

— Po përse nuk e prisnit, i pandehur? A nuk e shihnit ju se këta dy «të fejuar» ishin krejt të papërshtatshëm për njëri-tjetrin?

— Nuk e prisnim, shoku kryetar, se ky i ati i Fatimes, Shaban Isufi, ka qenë gjithmonë burrë zakoni, mandej ndaj familjes së Xhelal Idrizit ka pasur disa detyrime...

— Për çfarë detyrime e keni fjalën i pandehur?

— Familje e Fatimes, i ati dhe i gjyshi kanë pasur një miqësi të vjetër familjare midis tyre... Mandej fejesa është lidhur me shpërblim. Shaban Isufi ka marrë nga dhëndrri një shumë të mirë lekësh.

— Pra ju u shqetësuat për lekët, i pandehur?

— Për të dyja, shoku kryetar. Edhe për lekët edhe për Fatimen. Xhelali e donte vajzën.

Porsa tha këto fjalë shkesi, në mes të njerëzve, që dëgjonin zhvillimin e gjykimit, shpërthyen të qeshura. Dhëndrri, që strukej në bankën e të akuzuarit, e ndjente veten shumë ngushtë dhe dukej që atje tej se nuk i përshtatej aspak roli i njeriut të dashuruar. Edhe vetë Tomorit dhe ndihmësgjyqtarëve të tij u vinte për të qeshur dhe me vështirësi mbanin seriozitetin.

— Mjaft, i pandehur. Na thoni tashti ç'ndodhi pas fjalimit të 6 shkurtit.

— Në mbrëmjen e ditës që Shaban Isufi dha fjalën para kuvëndit se e prishte fejesën e Fatimes, unë dhe Xhelali shkuam në shtëpinë e tij për të kërkuar sqarime, me qëllim që t'i kthenim mendjen sa më parë. Ne, bile e kërcënuam se, sipas kahunit, ky turp lahej vetëm me gjak, por ai s'lëvizte

nga e tija deri sa më në fund na nxori përjashta fare nga shtëpia. Si e pamë kështu, ne vendosëm ta ruanim Fatimen dhe ta rrëmbenim me forcë. Pas kësaj ai dashur pa dashur do të pajtohej me ne.

— E ruajtët?

— Si urdhëron, që të nesërmen, por s'bëmë gjë. Ishte një ditë prilli me shi, shumë e përshtatshme për këtë punë, sepse nëpër ara s'kishte njeri. Ne e pamë Fatimen tek shkante në rrugën e madhe të fshatit, që të shpie në qytet, por nuk e rrëmbyem dot.

— Pse kështu?

— Shoqërohej nga një djalosh me xhakete ushtarake. Ne nuk e njihnim mirë, por na ngjau si një traktorist i NBSH.-së që porsa ishte kthyer nga ushtria. Xhelali u bë xheloz dhe u shqetësua shumë. Gjithë rrugës i ndoqëm këmba-këmbës. Kur mbërritën në qytet, na humbën nga sytë.

«Djaloshi me xhakete ushtarake!..»

Ai po hynte përsëri në këtë proces si një shqetësim i largët.

Ajo menjëherë u trondit kur dëgjoi të flitej për të dhe, padashur, iu kujtua ajo ditë kur kishin shkuar së bashku në qytet, për të kërkuar ndihmë nga komiteti i rinisë. Sa frikë kishte pasur se mos e ndiqnin shkesi dhe i fejuari i saj dhe kjo paskishte ndodhur vërtet!

Dhe Fatimes i kalonin nëpër mend këto mendime.

Megjithëse ky ishte një moment i vështirë në jetën e saj, ai udhëtim për në qytet së bashku me Vedatin i kishte mbetur si një kujtim i bukur dhe i këndshëm, që e sillte ndër mend sa herë që ishte

vetëm. Mirëpo tashti që kishte rrezik të dilte emri i tij në këtë gjyq, që zhvillohej para bashkëfshatarëve të saj, u trondit. U qetësua vetëm kur pa se si gjykatësi ja preu fjalën shkesit, duke thënë:

— Mjaft tashti. Të vijë dëshmitarja Ilirjana Vasili, sekretare e organizatës së rinisë.

Ajo kaloi përmes njerëzve dhe iu afrua me ngadalë tavolinës së trupit gjykues. Kishte ardhur çasti që ky shkes i keq dhe bashkëpunëtori i tij të jepnin llogari përpara popullit. U hodhi një vështrim dy të pandehurve, që rrinin në bankën e të akuzuarve dhe po priste Tomorin që t'i drejtonte pyetjet.

— Na thoni, dëshmitare, — pyeti ai, — ç'dini ju rreth çështjes që po gjykojmë sot.

— Unë nuk kam qenë në këtë fshat kur ishte fejuar Fatimja — tha Ilirjana qetësisht. — Erdha këtu pasi mbarova shkollën pedagogjike dhe fillova punën si arësimitare në shkollën e fshatit. Duke punuar njëkohësisht edhe si sekretare e organizatës së rinisë, pata rastin të mësoja dramën e Fatimes dhe të shumë shoqeve të tjera si ajo. Ma tregoi vetë Fatimja një ditë mbasi mbaruam mbledhjen e rinisë. Ajo nuk ishte dakord me këtë fejesë të lidhur sipas zakoneve prapanike, por nuk dinte ç'të bënte. Prindërit i respektonte shumë dhe kishte frikë se do t'i dëshpëronte, po të shpallte me inisiativën e saj prishjen e fejesës. Si sekretare e rinisë, e këshillova që ta bënte këtë sa më parë, pasi të mundohej një herë të bindte prindërit me të mirë. E pashë se ishte në hall dhe nuk dinte ç'të bënte. Ajo nuk guxonte. Kaloi kështu një kohë gjersa erdhi shkurti i këtij viti. Fjalimi i shokut Enver i dha guxim jo vetëm asaj, por

edhe të atit që ta prishte këtë fejesë të lidhur sipas zakoneve prapanike. Kjo ndodhi në kuvendin e popullit, kur u punua fjalimi i shokut Enver. U duk sikur tashmë gjithshka ishte në rregull. Po atë mbrëmje, që u bë kuvendi i popullit dhe fshatarët i dhanë fjalën partisë se do t'i prishnin fejesat e lidhura sipas zakoneve prapanike, ne arësimtarët e fshatit ishim mbledhur në një nga klasat e shkollës dhe po bisedonim për këtë mbledhje me rëndësi. Ora ishte më tepër se dhjetë e mbrëmjes. Ne diskutonim me zë të lartë, prandaj mezi e dëgjua një të trokitur të lehtë në derë. Njëri nga shokët tanë e hapi derën dhe pa atje Fatimen tek rrinte e dëshpëruar dhe e tronditur. Kishte lidhur në kokë një shami dhe sytë i kishte të mbushur me lot. Pasi e hoqa mënjanë, e pyeta si e kishte hallin. Më tregoi se ç'kishte biseduar atë natë i ati me shkesin dhe të fejuarin e saj dhe më pyeti se ç'duhej të bënte. Unë e këshillova që të shkonte në qytet dhe t'i denonconte në prokurori. Meqë ajo nuk e dinte se ku ishte prokuroria, i dhashë një copë letër për sekretarin e rinisë së rrethit, ku i lutesha që ta ndihmonte.

— Ditën e ngjarjes keni qenë e pranishme ju, Ilirjana? — pyeti Tomori.

— Jo, shoku kryetar. Për këtë kanë dijeni sekretari i partisë dhe shokë të tjerë.

— Falemnderit për shpjegimet — tha Tomori.
— Ju mund të largoheni. Të vijë dëshmitari Pertef Llulla.

— Ne ishim informuar nga komiteti i partisë — tha Pertefi, — se dy të pandehurit, duke qenë të verbuar nga zakonet prapanike të së kaluarës, po pregatisnin rrëmbimin e Fatimes. Të ndodhur

para një krimi që po pregatitej, ne i thirrëm dy të pandehurit në zyrën e këshillit popullor. Isha unë, kryetari i këshillit dhe kryetari i kooperativës. Ata të dy e mohuan krejtësisht se po pregatisnin diçka të tillë, bile u hoqën si të çuditur se nga e kishim marrë vesh. Pavarësisht nga qëndrimi i tyre, ne vendosëm të ishim vigjilentë dhe të kujdeseshim për ta ruajtur Fatimen nga çdo e papritur. Kështu që ditën e ngjarjes...

— Na shpjegoni me hollësi, shoku Pertef, ç'ndodhi atë ditë. — pyeti Tomori.

— Ne ishim në fushë duke punuar. Ca më larg ishte edhe Fatimja me një skuadër grash. Në një çast, kur ajo shkoi për të mbushur ujë në burim, dy të pandehurit iu afruan tinëzisht nga prapa. Ajo i pa kokët e tyre tek pasqyroheshin në ujët e burimit dhe klithi. Ndërkaqë ata e kishin kapur për krahu dhe po e tërhiqnin duke u munduar që t'i zinin gojën të mos bërtiste. Ne e dëgjuaam klithmën e saj dhe vrapuam në ndihmë. Dy të pandehurit, kur e kuptuan se u zbuluan, ja shkelën vrapit, por nuk bënë as treqind metra, sepse prapa asaj kodrës, që duket atje u preu rrugën një traktorist i NBSH-së. Ishte një djalë i shëndoshë, që porsa ishte kthyer nga ushtria. Duke i kërcënuar me një çelës maqinash në dorë, ai kërkoi që të ndaleshin në vend. Ndërkaqë arritëm edhe ne, i kapëm dhe i dorëzuam në organet e policisë popullore.

— Mjafton me kaq, shoku Pertef, — tha Tomori. Sqarimet janë të plota.

Para se të mbyllej hetimi gjyqësor, Tomori pyeti në kishte ndonjë nga populli që donte të fliste rreth çështjes. U ngritën menjëherë shumë duar.

Në fillim ai ja dha fjalën një plake të veshur me të zeza. Teze Rukja kishte një fytyrë të mprehtë dhe një mjekër pak të dalë. S'kishte diskutuar ndonjëherë në mbledhjen e fshatit, prandaj ndokush edhe buzëqeshi lehtë tek e pa që përtypej e s'dinte ç'të thoshte më parë.

— Një fjalë e vjetër thotë se shtamba vete sa vete për ujë dhe thyhet njëherë. Kështu i ndodhi edhe këtij Nazmi Haxhiut. Gjithë jetën ka që merret me këto punë dhe nuk heq dorë as tashi që po mplaket. Folë, more shkes i vjetër, sa vajzave jau ke nxirë jetën?... — bërtiti teze Rukja, duke iu drejtuar shkesit. — folë tashti, përse nuk flet?! Përse tashti rri si nuse e bukur, sikur s'di të thuash asnjë fjalë? Sa mirë dije atëhere, kur bëje këto pazarllëqe. Dhëndrri kështu, nusja ashtu, derë e mirë, shtëpi e pasur, me bagëti, me shtëpi, me para... Këtë, more djem, — tha pastaj duke u drejtuar nga trupi gjykues, — duhet ta dënoni një herë e mirë për ato që ka bërë ndaj Fatimes dhe ndaj shumë vajzave të tjera që s'i themi dot emrat tashi se janë gra me femijë...

— Po ty, teze, kush të ka fejuar, — e provokoi dikush nga mesi i njerëzve.

Teze Rukja u pre. Fjala i mbeti e pambaruar dhe vështroi atë që kishte folur pak më parë.

— Ti e di — i tha — kush më ka fejuar... Burri im ka vdekur para 30 vjetve, se ishte plak dhe s'është mirë ta zëmë në gojë, por meqë do ta dish, po ta them: Më ka fejuar i ati i këtij Nazmi Haxhiut, se edhe ai me këtë punë rronte. Isha vetëm 8 vjet kur më fejuan, kurse burri 38...

— Tjetër kush e do fjalën?... — pyeti Tomori.

U ngrit një i ri që kishte qenë shok shkollë me Fatimen, pas tij foli një fshatar, që e kishte fejuar edhe ai të bijën dikur që në djep me ndërhyrjen e Nazmi Haxhiut. Duke diskutuar një-ri pas tjetrit, vajti vonë. Kur shpalli vendimin Tomori ishte ngrysur. Pasi u përshëndet me fshatarët, ai u nis për në qytet.

* * *

Tomori zbriti nga maqina dhe mori rrugën për në shtëpi. Pasi doli nga bulevardi, hyri në rruqicat që ndriçoheshin zbetë nga llambat elektrike. Nga dritaret e shtëpive dëgjohej spikeri i Radio Tiranës që jepte lajmet e orës tetë të mbrëmjes, zëra fëmijësh, të qeshura, një jehonë jete, që vërshonte në rrugët e këtij qyteti të vogël.
